

Referendumi

Shpresë
te heshtja
e Mickovskit

Fq.3



BORXHET PUBLIKE

Kryeson Ohri,
Tetova e dyta me
borxhe më të larta

Fq.6



Iidentiteti,
bythecët
dhe
korrektësia
politike!

Fq.11



Koha

www.koha.mk



KOHA për
kulturë

Fq.12-13

RAJON

Nuk të
dëgjon kush?
Vuçiq mos
u zemëro kaq



Presidenti serb Aleksandar Vuçiq ka vendosur që të fillojë një fazë të re në raportet me bashkësinë ndërkombëtare, që mund të quhet edhe si bojkotim i heshtur i Brukselit dhe Uashingtonit. Vendimin e ka marrë Vuçiqi, por e ka publikuar...

Fq.14

DOSSIER

Kur Dibra ra
në duart e
komunistëve

Fq.18

GLOBI

Plani B i May
dhe lëkundja
e Merkelit

Fq.15

SPORT

Lirimi vendos
rekord në
Formula 4

Fq.19



REFUZOHET DËMSHPËRBLIMI PËR SHQIPTARËT E PAFAJSHËM

SOPOTI DËNOHET SËRISH



Shqiptarët e "Sopotit", pos që mbajtën dhjetëra vite burgim, përsëri do të duhet të nisin të "shëtisin" nëpër korridoret e gjyqësorit të Maqedonisë. Kësaj radhe pranë Gjykatës Civile të Shkupit duhet ta kërkojnë të drejtën për dëmshpërblim, pasi ministrja Renata Deskoska ua refuzoi kërkesën për dëmshpërblim

Fq.4

Mbi 100 mijë qytetarë me llogari të bllokuara

Shkup, 24 shtator - Përfundimisht me muajin gusht të këtij vit, mbi 75 mijë kryefamiljarë kanë vështirësi për t'ju siguruar bukën e gojës familjarëve të tyre. Kjo pasi përmbaruesit kanë bllokuar llogaritë bankare transakcionale të këtyre qytetarëve për mos pagesë në kohë të faturave energjetike, ujit, mbeturinave, taksës radiodifuzive, si dhe faturave të papaguara ndaj operatorëve për dhënie të shërbimeve telefo-

nike. Pikërisht për këtë, deputeti rom Samka Ibraimoski ka kërkuar nga deputeti Panço Minov, propozues i Ligjit të ri për fshirjen e kamatave për të gjitha borxhet e mbetura, që qytetarët për shkak të gjendjes së rëndë financiare që kanë, të paguajnë vetëm borxhin bazë të mbetur dhe jo edhe kamatat dhe shpenzimet enorme të përmbaruesve. Madje, Ibraimoski i ka kërkuar...

Fq.5



EDITORIAL

“KORRIGJIM” I THAÇIT ËSHTË “SHKËMBIM”



Daut DAUTI

Edhe budallai më i madh e din që ky muhabet nuk ka kuptim dhe se ‘korrigjimi’ i Thaçit është ‘shkëmbim’. Prandaj, njerëzit me të drejtë dyshojnë se Thaçi e ka ndërmend që Serbisë t’ia jep Veriun në shkëmbim me Luginën

Bisedimet që janë duke u zhvilluar në mes Thaçit dhe Vuçiqit janë mjaft të çuditshme. Ato nuk janë transparente dhe ky fakt ka krijuar brengë te njerëzit. Janë tri terme që e përshkruajnë debatin publik në lidhje me këto bisedime: 1. Ndarja e Kosovës; 2. Shkëmbimi i territoreve; dhe 3. Korrigjimi i kufijve.

Duhet të ndalemi për një analizë të shkurtër të pika e tretë: korrigjimi i kufijve. Në situatën ekzistuese ky term nuk krijon kurrfarë kuptimi. Me fjalën korrigjim, në përgjithësi, ne kuptojmë përmirësimin e një pune të kryer. Ta zëmë, kur e kemi shkruar një tekst, ne e kemi kryer punën. Por, kjo punë, edhe pse e kryer, kërkon intervenim të mëtejshëm për t’u finalizuar para botimit. Në këtë rast, teksti lekturohet dhe në raste të shpeshta edhe redaktohet. Ose, e kemi ndërtuar një shtëpi por nuk mund të hyjmë në të pasi që instalimi i rrymës ose i ujit kërkon ca intervenime. Dmth. e thërrasim ndërtuesin që t’i korrigjoj këto gabime.

Sipas Thaçit, në rastin e Kosovës dhe Serbisë, del që puna është kryer por kanë mbetur disa gabime të vogla që kërkojnë korrigjim. Tashti, duket se duhet ta thërrasim gjeodetin, i cili, me atë pantikën e tij, e rregullon vijën kufitare diskutabile diku në një kodër të vogël apo në bregun e ndonjë përroske.

Në fakt, ne të gjithë e dimë se situata është ndryshe dhe se Thaçi e përdorë termin ‘korrigjim’ për ta fshehur ‘shkëmbimin’. Puna nuk është aspak e kryer pasi që Serbia nuk e pranon Kosovën e as kufijtë e saj. Të mos harrojmë se Serbia e konsideron Kosovën si territor të saj. Pra, pasi që ajo nuk i njeh kufijtë, ne nuk kemi se çka korrigjojmë.

Megjithatë, Hashim Thaçi insiston se ky term është zbulim i tij dhe në rastin konkret nënkupton përfshirjen e Luginës së Preshevës në Kosovë, e cila gjë, në parim është tërësisht në rregull. Ai, më tutje, për të krijuar edhe më shumë konfuzion, deklaroi pandërprerë se me Serbinë nuk është duke biseduar për ndarje e as për shkëmbim të territoreve. Nga kjo nënkuptohet se Kosova do ta marrë Luginën dhe, pasi që nuk do t’i jep asgjë Serbisë, do ta shton territorin e Kosovës.

Edhe budallai më i madh e din që ky muhabet nuk ka kuptim dhe se ‘korrigjimi’ i Thaçit është ‘shkëmbim’. Prandaj, njerëzit me të drejtë dyshojnë se Thaçi e ka ndërmend që Serbisë t’ia jep Veriun në shkëmbim me Luginën. Me këtë rast zbatohen vetëm dy kriteret që njihen deri sot. Fjala është për kriterin faktik dhe atë etnik. Kriteri faktik është në dobi të Serbisë pasi që ajo e ka nën pushtet legjitim Luginën dhe faktikisht e kontrollon Veriun. Kriteri që duhet të zbatohet në këtë rast është ai etnik. Në Veri duhet të merret gjendja ekzistuese e janarit të vitit 1998.

Nëse nuk zbatohet ky kriter, atëherë Thaçi dhe askush tjetër nuk duhet të vazhdoj asnjë bisedë me askënd. Në këtë rast Kosova është më mirë të mbetet siç është sot.

TRAGJEDITË SI KJO E JEMENIT, JANË DUKE U SHTUAR

“Tragjedia e 22 milionë civilëve në Jemen është rrëqethëse. Sipas raportimeve të organizatave kredibile, 22 milionë njerëz vuajnë nga uria. Shumë prej tyre po ushqehen vetëm me gjethe! Edhe përkundër kësaj gjendjeje, forcat rivale vazhdojnë luftën civile, të ndihmuara nga fuqitë rajonale, Irani dhe Arabia Saudite.

Tashmë është faktuar se nga bombardimet janë kryer edhe krime kundër njerëzimit. Fuqitë e Mëdha po hulumtojnë përparësitë e veta strategjike, që mund të përfitohen nga kjo krizë. Komuniteti ndërkombëtar po tregohet i pafuqishëm, edhe për ofrimin e ndihmave humanitare!

Siç prognozonte Brzhezinski, bota ka dalë ‘jashtë kontrollit’. Ndaj, drejtuesve të shteteve të vogla e të brishta u kërkohet maturi, sepse kërcënimet me tragjedi si kjo e Jemenit, janë duke u shtuar. Bile edhe në hapësirën tone”, ka shkruar një status në Facebook shkrimtari Milazim Krasniqi.

PËRZËNIE E ÇAMËVE LIDHET ME LASHTËSINË E TYRE

“Shqiptarët në Epir-Çamëri kanë banuar në vendbanimet e lashta antike, përzënie e shqiptarëve nga Çamëria lidhet edhe me lashtësinë e tyre. Romakët, Sllavët, Venedikasit dhe Osmanët në Epir u ndeshën vetëm me shqiptarët. Po grekët ku ishin? Termi grekë ka lindur rreth vitit 1850. Bile për grekët termi GREK është poshtëruar, ata më mirë parapëlqejnë të quhen ROMEL, gjuha ROMAİKOS”, ka shkruar në profilin e tij në Facebook, historiani Arben Llalla.

NUK DIHET SE NË CILËN EPOKË NA ËSHTË PRISHUR FARA SI POPULL!

“Me pesë rreshta mund ta përmbledhësh mentalitetin, kulturën, ligjin, shtetin... në Shqipërinë tonë.

Një burrë i bllokun rrugën shtëpisë së vëllait, duke e mbjellë me ullinj. Kunata ankohet, e padit dhe INUK vjen i shkul ullinjët. Policia ndalon burrin që kundërshtoi me forcë dhe kërcënoi inspektorët. Pas një nate, policia e liron dhe burri me të vajtur në shtëpi, thërret djemtë për ndihmë dhe i thyen gjysmat e kockave kunatës, gruas së vëllait... Çfarë ndodh nëpër fshatra...

Fqinjët janë të gjithë në hasmëri sepse, burra si ky soji, i lënë tokat pa punuar, por fiqtë dhe ullinjët i mbjellin mu në vijën e kufirit, që degët të hapen nga toka e komshiu. Burra si ky, e kullosojnë lopën dhe pulat në tokën e fqinjit. Burra si ky, kur punojnë tokët e tyre, gurët që pastrojnë i hedhin nga toka e fqinjit.

Nuk ka shtet në botë ç’ti bëjë këtij soji o njerëz. Është fara e prishur, nuk dihet në cilën epokë!”, ka shkruar në profilin e tij në Facebook, gazetari nga Tirana, Mentor Kikia.

MEDIA Citate

GJERMANËT KRENARË ME MERKELIN DHE MERCEDESIN

Kur bëhet fjalë për personalitetet historike, gjermanët janë krenarë me politikanët e tyre - kështu ndodh edhe me kancelaren e tanishme Angela Merkel, e cila gëzon popullaritetin më të madh mes gjermanëve, shkruan konservatorja gjermane WELT AM SONNTAG.

Anketa është kryer në fund të korrikut 2018 dhe pjesë e saj kanë qenë 1047 persona. Atyre u është kërkuar të përzgjedhin tre personaliteteve nga fusha të ndryshme (politikë, shkencë, sport dhe kulturë), të cilët në të kaluarën i kanë bërë krenarë.

Në krye të ranglistës është Angela Merkel, ku është përmendur nga 16 për qind e të gjithë anketuarve. Menjëherë pas saj, ndodhet politikani i majtë Helmut Schmidt (SPD) me 11 për qind, ndërsa më pas ndodhen Willy Brandt (SPD) dhe Helmut Kohl (CDU), secili me 6 për qind. Të gjithë përveç Merkelit, kanë ndërruar jetë.

Lista ndiqet me Frank-Walter Steinmeier pesë për qind dhe Konrad Adenauer (CDU) me katër për qind, përcjell albinfo.ch.

49 për qind e të pyeturve kanë përmendur politikanë në përzgjedhjen e tyre. Si sportist më i vlerësuar në anketë shfaqet Joachim Löw me tre për qind, kurse si shkrimtar dhe shkencëtar shfaqet Johann Wolfgang von Goethe dhe Albert Einstein, secili me dy për qind.

Në pyetjen se cili qytet i bën më krenarë gjermanët, vendin e parë e zë Berlioni, ndërsa më pas Mynihu. E njëjta pyetje është parashtruar për firmat, ku dominojnë fabrikat e automobilave. Mercedes ndodhet në vendin e parë me 17 për qind, ndjekur nga Volkswagen (16 për qind) dhe BMW (11).

(WELT AM SONNTAG, 24 shtator)

NËSE NUK E KENI DITUR...

KUSH ISHTE HODO SOKOLI?

Hodo Sokoli (1841-1883) ishte veprimtar i dalluar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kryetar i Komitetit të degës së Lidhjes për Shkodrën për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit. Që në fillim të vitit 1880 doli hapur kundër vendimit të Portës së Lartë për t’i dorëzuar Malit të Zi Hotin dhe Grudën dhe në mënyrë demonstrative zhveshi publikisht uniformën e kolonelit të xhandarmërisë

turke. Në prill-korrik 1880 Hodo Sokoli drejtoi luftimet për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës dhe dha një ndihmesë të rëndësishme për kurorëzimin me sukses të luftës së vullnetarëve shqiptarë kundër ushtrisë së rregullt malazeze.

Pas rënies së Ulqinit në duart e Malit të Zi, Hodo Sokoli u arrestua dhe u internua në Anadoll, prej nga nuk u kthye më.

EDHE KATËR DITË NGA MBYLLJA E FUSHATËS

SHPRESË TE HESHTJA E MICKOVSKIT

Në prag të mbylljes së fushatës, sipas informatave jozyrtare, diplomatë të huaj dhe pushteti po punon me kryetarin e VMRO-së, Hristijan Miskovski dhe shumicën e Kryesisë së partisë që në moment të fundit, të aktivizohen për të mbështetur referendumin, më saktë për të punuar në arritjen e sigurt të censusit prej 50 plus 1 votë për të qenë i suksesshëm votimi i 30 shtatorit



Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 24 shtator - Katër ditë nga mbyllja e fushatës për referendumin, partitë në pushtet dhe partitë shqiptare opozitare bëjnë fushatë intensive në terren më synimin që të garantojnë suksesin e referendimit. Nga ana tjetër, VMRO opozitare, konkretisht kupola udhëheqëse e saj në krye me Hristijan Mickovskin, ende nuk e thonë qartë se do të dalin apo jo të votojnë në referendum. Ndërkaq një pjesë e deputetëve të tyre që lidhen më shumë me grupin e deputetëve të akuzuar për ngjarjet 29 prillit, si dhe president Ivanov, kanë shprehur hapur qëndrimin se do të bojkotojnë votimin e 30 shtatorit.

Megjithatë, në prag të mbylljes së fushatës, sipas informatave jozyrtare, nga diplomatë të huaj dhe nga pushteti punohet në prapaskenë me kryetarin e VMRO-së, Hristijan Miskovski dhe shumicën e Kryesisë që në moment të fundit të aktivizohen për të mbështetur referendumin, më saktë për të punuar për arritjen e sigurt të censusit prej 50 plus 1 votë për të qenë i suksesshëm.

Flitet po ashtu se VMRO, si rezultat edhe i presionit të faktorit ndërkombëtar, në forma jo deklarative dhe në mënyrë të heshtur do të aktivizojë strukturat partiak që të ndihmojnë në daljen e anëtarësisë së saj në votim, pa mos u lodhur shumë me elementin radikal në këtë parti që dihet se janë kundër referendimit. Nga ana tjetër, mungesa e një plani B të VMRO-së kundrejt marrëveshjes për emrin me Greqinë, ka shtetur argumentet tek kauza e kësaj partie kundër kësaj marrëveshjeje. Deputetë dhe funksionarë të VMRO-së që mbajnë qëndrime të

ashpra kundër referendimit, llobojnë në parti se dështimi i referendimit mund të çojë vendin në Qeveri teknike, dhe më pas zgjedhje të parakohshme parlamentare që do të fitojë, sipas tyre, VMRO dhe po kjo parti më pas të arrijë një marrëveshje të re me pushtetin në Greqi. Për këtë të fundit, grupi kundër referendimit në VMRO shpreson se nuk do të jetë Syriza, por në pushtet në Greqi do të vijë Demokracia e Re me të cilën kanë bashkëpunim tradicional. Por se si do të shkojë puna më tutje, ka rëndësi dhe qëndrimi që do të mbajë ish-lideri i VMRO-së, Nikola Gruevski, por dhe me peshë është edhe qëndrimi i ish shefit të DSK-së, Sasho Mihajlkov, më të cilin më shumë janë të lidhur grupi kundër referendimit në VMRO.

Në rast se dështon mbështetja e VMRO-së, po llogaritet në aktivizimin maksimal të votës shqiptare, rome, turke, boshnjake dhe serbe. Por sa i përket operativës partiake, partitë shqiptare si ato në pushtet BDI, PDSH dhe grupi i Afrim Gashit i LB-së ashtu dhe partitë në opozita - Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA, po llogaritet çelësi i suksesit për të arritur censusin prej 50 plus 1 për qind.

NENET KUSHTETUTËS DO TI SHKRUAJMË NE

Kur jemi tek qëndrimet kundër, presidenti Gjorge Ivanov foli hapas së fundmi se ai personalisht nuk do të marr pjesë në votim më 30 shtator ditën e mbajtjes së referendimit. Të menjëhershëm kanë qenë dhe reagimet e LSDM-së dhe nga ana e ministrit të Punëve të Jashtëm, Nikolla Dimitrov. Ky i fundit, të hënë gjatë një konference për shtyp foli enkas se çfarë do të ndryshohet në Kushtetutë nga ajo

që shkruhet në Marrëveshje për emrin. Nikolla Dimitrov u kujdesi të sqarojë opinionin se formulimet në nenet e Kushtetutës që do të ndryshohen do të përpilohen në mënyrë të pavarur nga vetë klasa politike në vend. Dimitrov ka potencuar se amendamentet do të përfshijnë katër çështje: Përcaktuesin gjeografik, mosndryshimin e kufijve dhe përkufizimin e hapësirave territoriale, përkujdesje për komunitetet që jetojnë në Maqedoni, duke pasur kujdes për diasporën dhe narrativin historik që nis me Kryengritja e Ilindenit e deri te ASNOM-i.

"Për ne, Ilindenin nis me pavarësinë e shtetit tonë, kurse Bullgaria ka qasje tjetër të po të njëjtës ngjarje historike", tha Dimitrov, duke theksuar se "do të rimerohen vendimet konkrete të ASNOM-it".

"Formulime nuk ekzistojnë, as nuk janë negociuar, ata do të përpilohen nga ne", tha Dimitrov. Ai ka sqaruar nenet që kanë të bëjnë me emrin e shtetit, me kombësinë dhe me gjuhën. Sa i takon amendamenteve, Dimitrov tha se ata nuk janë negociuar me Greqinë dhe se formulimi i tyre do të bëhet nga pala e Maqedonisë. "Në pjesën e amendamenteve kushtetuese, ata as nuk janë negociuar dhe as nuk jemi marrë vesh. Do të shqyrtohen me debat publik dhe do të miratohen me 2/3 e votave në Parlament", tha Dimitrov.

Në lidhje me qëndrimin e presidentit Ivanov, Dimitrov tha se përgjigjja e tij se nuk do të votojë në referendum, nuk e ka befusuar asnjërin në vend. "Të thuhet se nuk votohet, është ikje e turpshme nga përgjegjësia dhe kjo nuk thuhet në Maqedoni, por përtej oqeanit", deklaroi ministri i Punëve të Jashtme, Dimitrov në konferencën e

djeshme për shtyp në Qeveri.

"Shpesh referohet se është këtu për ta mbrojtur Kushtetutën, megjithatë Kushtetuta nuk mund të mbrohet me shkelje. Ne nuk jemi sistem presidencial, ne jemi demokraci parlamentare. Presidenti nuk ka veto të rezolutës. Ligji për Marrëveshjen me Greqinë kur u votua për të dytën herë në Parlament, sipas Kushtetutës, e obligon presidentin ta nënshkruajë. Ne jemi shtet demokratik, ndërsa qytetarët e bëjnë përzgjedhjen se kush do t'ju shërbejë me votim. Gjëja me demokratike në çdo demokraci është referendum. Të thuhet për këtë çështje për të cilën kemi humbur shumë gjenerata, 27 vite kontest i pazgjidhur, se nuk do të votojë, është ikje e turpshme nga përgjegjësia. Dhe kjo nuk thuhet këtu, por përtej oqeanit", tha Dimitrov.

Në ndërkohë, në LSDM thonë se në javën kyçe për të ardhmen e shtetit dhe qytetarëve të saj, Gjorge Ivanov vendosi të mos e braktisë idenë e tij për izolim të Maqedonisë.

"Është e dukshme se Ivanov është mësuar t'u shkaktojë probleme qytetarëve të vet, madje edhe atyre të cilët e votuan. Personi i fundit nga regjimi kriminal i VMRO-DPMNE-së, Gjorge Ivanov, është kundërshtar i demokracisë, sepse e konteston veçlën më të rëndësishme demokratike - votimin. E, pikërisht përmes votimit dhe zgjedhjeve, Ivanov u bë president. Qëndrimi i Ivanovit është ikje e turpshme nga përgjegjësia", thuhet në kumtesën e LSDM-së për media. Sipas kësaj partie, për fat të mirë të qytetarëve, Ivanov nuk është ai i cili vendos për të ardhmen. "Ivanov është person shumë pak i rëndësishëm, qytetarët dhe vullneti i tyre janë ata të

cilët janë shumica e Maqedonisë, ata do ta sjellin vendimin. Maqedonia do të zgjedh të ardhmen, Ivanov mbetet i vetëm, i robëruar në idenë personale për izolim", thonë nga LSDM. Për fat të keq, siç cekin nga kjo parti, Ivanov mbetet të jetë njeriu, i cili mbjell urrejtje dhe i cili i ndan qytetarët, presidenti i cili shkon në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, presidenti i cili zgjidhet përmes votimit, ndërsa sot ka problem me votimin.

VMRO: QEVERI SHPRONËSON POPULLIN MAQEDONAS

VMRO opozitare menjëherë ka reaguar ndaj LSDM-së. Nga kjo parti thonë se askush nuk ka të drejtë të luaj dhe si depozitë të vendosë emrin e shtetit. "Edhe sot do të përsëris se këto ndryshime dhe falsifikime të fakteve historike në Kushtetutë nuk do të përfundojnë këtu. Ata do të jenë themel të ndryshimit të gjithë asaj komisioni grek për revidim shumëvjeçar, fshirjes së librave shkollor, hartave, arkivave, ndryshim të kujtesës shtetërore por familjare dhe personale të tragjedi-ve dhe luftën e Maqedonisë. Për këtë arsye dhe pyetje qytetarët të mund të sjellin vendim të drejtë se si do të veprojnë më 30 shtator. Qeveria duhet të jetë e sinqertë dhe t'iu tregojë qytetarëve se më 30 shtator nuk vendosin për Maqedoni evropiane por se nëse do të shpronësohet populli i Maqedonisë dh të krijohet një shtet i ri i cili do të quhet 'Verior', tha të hënë gjatë një konference për shtyp, zëdhënësi i VMRO-së, Naum Stoilkovski. Në qoftë se, shtoi ai, Zaevi nuk ka se çfarë të fsheh lë të dalë në TV në duel me kryetarin Hristijan Mickovski dhe le ti hapë kartat.

DESKOSKA REFUZON DËMSHPËRBLIMIN PËR SHQIPTARËT E PAFAJSHËM

SOPOTI DËNOHET SËRISH



Shqiptarët e "Sopotit", pos që mbajtën dhjetëra vite burgim, përsëri do të duhet të nisin të "shëtisin" nëpër korridoret e gjyqësorit të Maqedonisë. Kësaj radhe pranë Gjykatës Civile të Shkupit duhet ta kërkojnë të drejtën për dëmshpërblim, pasi ministrja Renata Deskoska ua refuzoi kërkesën për dëmshpërblim

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 24 shtator - Endja nëpër gjykata dhe maltretimet e të dëmtuarve në rastin e "Sopotit" nuk kanë fund. Ministria e Drejtësisë së fundmi ka njoftuar se nuk e ka pranuar kërkesë për dëmshpërblim të të dëmtuarve në rastin e "Sopotit". Fakti se shqiptarët e Sopotit dhjetëra vite qëndruan të pafajshëm në burg, ndërsa për 15 vite u zvarritën nëpër korridoret e gjykatave të Maqedonisë, për ministren e Drejtësisë, Renata Deskoska nuk është arsye e mjaftueshme që shteti ta përmbyllë këtë kapitull në të mirë të tyre.

"Ne si Ministri e Drejtësisë nuk kemi refuzime të kërkesave për dëmshpërblim, por procedura vijon në bazë të vendimeve të Gjykatës, e cila ka vendosur se ato në mënyrë të padrejtë kanë qenë të paraburgosur dhe palët drejtohen tek ne për marrëveshje. Meqë nuk ka kritere se në bazë të cilave rregulla duhet të realizohet ajo marrëveshje, ne i udhëzojmë që të drejtën e dëmshpërblimit ta kërkojnë në procedurë gjyqësore. Kjo është një procedurë e zakonshme që vlen për të gjithë dhe nuk ka parime të posaçme që vlejné për rastin e "Sopotit", deklaroi të hënën Deskoska, duke e arsyetuar vendimin e ministresë që ajo drejton e që refuzon shlyerjen e dëmshpërblimit.

Për palën mbrojtëse dhe të dëmtuarit e "Sopotit", vendimi i Ministrisë së Drejtësisë paraqet shkeljen e radhës për shqiptarët e pafajshëm që vuajnë dënime të montuara politikisht. Ata nuk e kanë të qartë se si mundet ministrja të

kalkulojë me deklarata të llojit se "lënda është në zgjidhje e sipër", ndërsa tani del me qëndrim se të drejtën, sopotasit duhet ta kërkojnë në procedurë gjyqësore.

"Kjo është një papërgjegjësi e madhe. Në këtë rast ekzistojnë kritere, po ashtu ka edhe praktika gjyqësore ku janë dëmshpërblyer me mija raste. Nuk e kam të qartë se si Ministria e Drejtësisë ka vepruar në 1000 raste tjera për dëmshpërblime, por procedurat e mëhershme tash nuk vlejné. Dispozitat ligjore janë të qarta dhe thonë se palët e dëmtuara para se ti drejtohen gjykatës, duhet të drejtohen në Ministrinë e Drejtësisë për lidhjen e një marrëveshje për dëmshpërblim. Pas këtij vendimi, ne nuk kemi të drejtë ankesë, por duhet të ngrisim padi deri te Gjykata Civile e Shkupit. Ministria na ka dhënë përgjigje se nuk e miraton kërkesën për dëmshpërblim dhe se të drejtën tonë duhet ta realizojmë pranë gjykatave përkatëse. Ata e pranojnë të drejtën tonë, por thonë se ajo duhet të realizohet në proces gjyqësor. Zakonisht, këto procese zgjasin me vite dhe të dëmtuarit detyrohen të përballen edhe me një maltretim psiko-fizik, përfshi edhe atë material. Ndërkohë të dëmtuarit tanë lodhur e rraskapitur nga ecja nëpër gjykata", sh-

prehet i zhgënjyer avokati Vullnet Paçuku.

Për parashtrimin e padisë deri te Gjykata Civile e Shkupit, procedurat ligjore parashohin që çdonjëri prej të dëmtuarve në rastin e "Sopotit" duhet të shpenzojë nga 3 mijë deri në 5 mijë euro harxhime. Këto harxhime, siç njofton avokati Paçuku, shkojnë për taksat, jo për angazhimin e avokatëve.

"Fillimisht taksa e padisë kushton 500 euro, pastaj 800 euro është taksa e vendimit, 170 euro ekspertiza, ankesat kushtojnë nga 1600 euro. Këto harxhime më pas do të kthehen, mirëpo ku ti marrin ata tani nga 5 mijë euro për të dorëzuar padinë? Ata luftojnë për ekzistencë e lëre më të kenë nga 5 mijë euro. Ky është një vendim tepër skandaloz. Ajo që më së shumti na irriton neve është deklarata e ministres e cila javë më parë tha se ministria do ti dëmshpërblej të dëmtuarit e rastit të Sopotit, madje publikisht e theksoi këtë rast, ndërsa tani sjell vendim për jo", thekson Paçuku.

Ndryshe, pala mbrojtëse e të dëmtuarve për rastin e "Sopotit", thotë se Ministria ende ka kohë për ta përmirësuar gabimin (vendimin) e tyre. Sidoqoftë, sipas avokatit Paçuku, ata kanë filluar me përgatitjet për dorëzimin e padisë.

KLAIQI: VENDIM SKANDALUZ I MINISTRISË SË DREJTËSISË

Të shokuar dhe të habitur nga vendimi i Ministrisë së Drejtësisë, të dëmtuarit e rastit të "Sopotit", me shumë dhimbje e kanë pranuar qëndrimin e ministres Renata Deskoska, e cila nuk e pranoi kërkesën për dëmshpërblim. Njëri prej të dëmtuarve në rastin e "Sopotit", Zenel Klaiqi, për gazetën KOHA, thotë se është i habitur nga ky vendim i padrejtë i ministresë. "Sinqerisht kjo është një katastrofë e madhe. Maltretimet nëpër gjykata dhe polici nuk kanë mjaftuar, tash përsëri si duket duhet të shkojmë nëpër gjykata. Mirëpo, ne nuk dorëzohemi do të shkojmë deri të fund. Burgun pa faj e kemi mbajtur. Akuzat na i kanë montuar dhe përsëri shteti po na çon në proces gjyqësor të ankohemi. Padrejtësi e madhe është kjo", shprehet i mllefosur Klaiqi.



KRONIKË

Kapen bullgaret që vidhnin në Tetovë

Sektori për Punë të Brendshme Tetovë plotësisht ka zbardhur tre vjedhje, gjatë të cilave janë vjedhur çanta dhe portofole, ku gjatë gjysmës së parë të muajit gusht dhe gjatë këtij muaji, janë kryer nëpër butiqe dhe në rrugë të Tetovës. Ndaj të dyshuarve janë ngritur kallëzime penale, ndërsa tre gra kanë qenë shtetase bullgare. Bëhet fjalë për 25 vjeçaren S.S. nga Republika e Bullgarisë, si dhe dy bashkëkombase të saj minorene, të moshës njëra 15 dhe tjetra 16 vjeçe. Tre shtetasit e Bullgarisë, të cilat në fillim të muajit të kaluar me taksi kanë arritur nga Shkupi në Tetovë, dyshohet se bashkë ose veçmas, kanë hyrë nëpër butiqe, goja se për të shikuar prodhimet në shitje, dhe me zgjuarsi kanë shfrytëzuar pakujdesinë e pronarëve të çantave dhe portofoleve, dhe në mënyrë të paligjshme, kanë përvetësuar të mira materiale pronësore, me vlerë, e cila llogaritet të jetë rreth 216 mijë denarë.

Të dehurit rrihen në Tetovë

Në afërsi të një objekti hotelierik, në rrugën "Nikolla Teslla" në Tetovë, është prishur rendi dhe qetësia publike, gjatë një përlëshje në të cilën kanë marrë pjesë A.R. 39 vjeç, dhe B.S. 24 vjeç, të dy nga Tetova. Dy pjesëmarrësit në përlëshje kanë qenë dukshëm në gjendje të alkoolizuar, janë arrestuar dhe mbajtur në Stacionin Policor në Tetovë, dhe pas zbardhjes së plotë të rastit dhe të gjitha detajeve në veçanti, ndaj tyre do të pasojnë edhe kundërvajtje adekuate, sipas Ligjit për kundërvajtje kundër rendit dhe qetësisë publike.

Dy zjarre në Shkup dhe një në Dellçevë

Gjatë ditës së djeshme janë regjistruar tre zjarre, nga të cilat dy në rajonin e Shkupit dhe një në Zvegër në rajonin e Dellçevës, të cilat sipas intervenimeve të brigadës për mbrojtje kundër zjarreve janë shkuar. Siç kumtoi sot MPB-ja, dje në orën 14:45 është paraqitur se në hyrje të Shkupit, pas pikës pagesore "Petrovec" ka shpërthyer zjarr në të cilin është djegur bari i thatë. Në orën 15:35 minuta nga ana e Brigadës së zjarrfikësve zjarri është shuar. Dje në orën 14:20 minuta është paraqitur se në fshatin Kuçkovë të Shkupit, në vendin e quajtur "Peria" në drejtim të fshatit Gračan, për arsye tani për tani të panjohura ka shpërthyer zjarr ku është djegur bari i thatë dhe pyll me drunj të shkurtër. Nga ana e Brigadës për mbrojtje kundër zjarreve, zjarri në orën 15:30 është shuar tërësisht.

42 vjeçari sulmohet nga tufa e qenve

Të hënën në mëngjes rreth orës 07 e 40 minuta, në fshatin Negotinë të Gostivarit, 42-vjeçari H.M. ka qenë i sulmuar nga një tufë qen endacakë. Sipas policisë, në moment për t'iu shmangur sulmit të qenve, është rrëzuar në anën e majtë dhe ka marrë lëndime të rënda trupore - thyerje të krahut. Me veturë M.H është dërguar në Spitalin e përgjithshëm "Ferid Murad" në Gostivar, ku pas marrjes së ndihmës mjekësore, është lëshuar për kurim shtëpiak. Punohet në zbardhjen e të gjitha detajeve lidhur me rastin. (U.H)

Ligji kështu si është miratuar, thotë deputetja Mirsada Emini-Asani, ja ka shumë paqartësi, sidomos kur borxhi bazë kalon në duart e përmbauesve

SËRISH KËRKOHEN NDRYSHIME LIGJORE

MBI 100 MIJË QYTETARË ME LLOGARI TË BLOKUARA

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 24 shtator - Përfundimisht me muajin gusht të këtij vit, mbi 75 mijë kryefamiljarë kanë vështirësi për t'ju siguruar bukën e gojës familjarëve të tyre. Kjo pasi përmbauesit kanë bllokuar llogaritë bankare transakcionale të këtyre qytetarëve për mos pagesë në kohë të faturave energjetike, ujit, mbeturinave, taksës radiodifuzive, si dhe faturave të papaguara ndaj operatorëve për dhënien e shërbimeve telefonike. Pikërisht për këtë, deputeti rom Samka Ibrahimovski ka kërkuar nga deputeti Panço Minov, propozues i Ligjit të ri për fshirjen e kamatave për të gjitha borxhet e mbetura, që qytetarët për shkak të gjendjes së rëndë financiare që kanë, të paguajnë vetëm borxhin bazë të mbetur dhe jo edhe kamatat dhe shpenzimet enorme të përmbauesve. Madje, Ibrahimovski i ka kërkuar Minovit ta tërheq ta tërheq propozimin dhe të përpunohet nga fillimi, duke i marrë parasysh edhe propozimet e reja lidhur me këtë ligj.

"Është mirë të tërhiqet Ligji për fshirjen e kamatave për borxhet e qytetarëve, sepse është tepër shqetësues fakti se 100.000 qytetarëve i kanë të bllokuara llogaritë



bankare nga përmbauesit dhe për këtë, familjarët me vite vuajnë për bukën e gojës. Në të shumtën e rasteve, qytetarët po mbeten pa rrogat mujore, pensionet apo ndihmat sociale...", është shprehur Ibrahimovski. Edhe deputetja e BDI-së, anëtare Komisionit për Punë dhe Politikë Sociale, Mirsade Emini-Asani, është e mendimit se Ligji i cili tanimë është miratuar nga anëtarët e Komisionit, ka nevojë të ndryshohet, ndërsa kërkoi që kjo të bëhet pasi të formohet Komisioni i posaçëm që do të zbatojë Ligjin e ri. "Propozimi-ligj për shlyerjen e kamatave për borxhet e qytetarëve ka kaluar edhe pse

ndoshta duhet të plotësohet dhe të pranoheshin vërejtjet e shumë anëtarëve. Për shkak se kemi raste kur personi është larguar nga puna për shkak se firma ku ai ka punuar ka falimentuar dha ai tani si i papunë, nuk ka mundësi financiare për të paguar borxhin e mbetur. Në të ardhmen, duhet në Ligjin e ri të futet edhe neni plotësues ku këtyre personave të mos mundet as përmbauesi apo as ndonjë institucion tjetër t'ju bllokoi llogaritë bankare derisa këta persona nuk gjejnë punë të re", ka thënë deputetja Emini-Asani. Ligji kështu si është miratuar, thotë ajo, ka shumë paqartësi kështu që Komisioni

i cili do të formohet për zbatimin e ligjit, do të duhet t'i këtë parasysh edhe vërejtjet anëtarëve të Komisionit.

"Meqë ne si anëtarë të Komisionit e kemi marrë për obligim t'i ndihmojmë qytetarët, atëherë le të përfshihen të gjithë kategoritë e personave që kanë gjendje të vështirë familjare, pasi ka raste kur borxhi bazë prej 1000 denarëve, kur kalon në duart e përmbauesve, rritet në 30.000 mijë denarë. Kjo është e patolerueshme, sepse nëse dikush në Maqedoni ka fituar shumë para, janë pikërisht përmbauesit, të cilët aspak nuk kanë pasur mëshirë ndaj qytetarëve",

thotë deputetja Mirsada Emini-Asani.

Ligji i cili u pranua nga deputetët parasheh që borxhet e mbetura deri në fund të vitit 2011 e për të cilët udhëhiqet lëndë përmbauesit nga përmbauesit për faturat e mbetura të papaguara për energji elektrike, ujit, mbeturinave, taksës radiodifuzive, si dhe faturave të papaguara ndaj operatorëve për dhënien e shërbimeve telefonike, qytetarët të paguajnë vetëm borxhin bazë të mbetur, por jo edhe kamatat. Njëherësh, propozues i Ligjit, deputeti Panço Minov kërkon që Ligji t'i detyrojë Këshillat drejtues të kompanive për borxhet të informojnë qytetarët përmes shpalljeve në ndonjë nga gazetatat ditore. "Shpallja të jetë edhe në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe dhe ti informojnë qytetarët se do të fillohet me shlyerjen e kamatave për borxhet e mbetura. Gjithashtu, në mënyrë plotësuese duhet të zvogëlohen edhe harxhimet procedurale. Ato janë shpenzimet e noterëve, avokatëve dhe përmbauesve. Gjithashtu, në të ardhmen përmbauesit nuk do të kenë të drejtë t'ju bllokojnë një të tretën e rrogës, por kjo do të jetë një e katërta e rrogës", thotë deputeti Minov.

LUFTA KUNDËR KORRUPSIONI ME DISPOZITA TË REJA

Antikorrupsioni me pëlqimin e mediave dhe OJQ-ve

Faktin se për gjashtë muaj të plotë në Maqedoni nuk funksionon Komisioni shtetëror për antikorrupsion, për Ministrinë e Drejtësisë nuk paraqet asnjë problematike, pasi siç u shpreh ministria Deskoska, qëllimi i tyre është formimi i një komisioni profesional dhe të pavarur

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 24 shtator - Shoqatat e gazetareve dhe sektori civil pritët të kenë përfaqësuesit e tyre në Komisionin parlamentar që duhet ta zgjedh përbërjen e re të Komisionit shtetëror për antikorrupsion-

nit. Ministria e Drejtësisë, Renata Deskovska, duke i elaboruar detajet e propozim-ligjit të ri për luftë kundër korrupsionit, tha se dispozitat e reja do të përbëjnë procedura transparente për zgjedhjen e anëtarëve të ri të Komisionit. Ndonëse deri më tani çdo pushtet nga viti 2002 e këndej deklarohet se Komisioni shtetëror për antikorrupsion duhet të përbëhet nga persona jo partiak, megjithatë formati i fundit i cili dha dorëheqje në mars të këtij viti, kryesisht përbëhej nga donatorë të partive politike. Shfuqizimi i këtij kriteri është risia që pritët ta ketë Ligji i ri për antikorrupsion.

"Njëri prej kriterëve të reja që do t'u kërkohet anëtarëve (konkurruesve) apo kryetarit të Komisionit, është kushti që ato të mos kishin kryer funksion politik në Qeveri apo Parlament, dhe aq më pak të mos kishin qenë donatorë në partitë politike gjatë

dhjetë viteve të fundit. Me këtë ndryshim dëshirojmë që Komisioni mos të ketë anëtarë të lidhur ngushtë me subjektet politike. Kriteret tjera lidhen me përvojën në zbulimin apo parandalimin e korrupsionit. Por gjithsesi garancioni më i fortë është procedura e zgjedhjes. Një prej alternativave që i përmban ky ligj është procedura transparente në Parlament për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit, ku shoqatat e gazetarëve dhe sektori civil që punon në sferën e korrupsionit do të kenë mundësi të propozojë përfaqësues, të cilët më pas do të marrin pjesë në intervistimin e kandidatëve për në Komision. Qëllimi ynë është krijimi i një procedure transparente, në bazë të së cilës opinioni do të ketë mundësinë të shoh se kush janë personat që kanë konkurruar", tha ministria Deskoska.

Faktin se për gjashtë muaj të

plotë në Maqedoni nuk funksionon Komisioni shtetëror për antikorrupsion, për Ministrinë e Drejtësisë nuk paraqet asnjë problematike, pasi siç u shpreh ministria Deskoska, qëllimi i tyre është formimi i një komisioni profesional dhe të pavarur.

"Sinçerisht dua që debati publik për këtë Ligj të përfundojë sa më shpejtë, në kuptim të asaj që propozimet dhe rekomandimet kualitative për ndryshime eventuale të tekstit ligjor ti pranojmë më herët dhe ky propozim, pas Referendumit, të dorëzohet në Parlament dhe nga fundi i tetorit të zgjedhim komisionin e ri. Përbërjen paraprake të Komisionit shtetëror për antikorrupsion, ndonëse e kishim, ajo në realitet nuk ekzistonte. Dorëheqjet e tyre rezultuan si shkak i dyshimeve dhe aferave korruptive që dolën brenda Komisionit. Më pas, në pajtim me rekomandimet e Ko-

misionit Evropian, u imponua krijimi i përbërjes së re dhe procedurave të reja për zgjedhjen e Komisionit në fjalë. Njëra prej opsioneve ishte zgjedhja e përkohshme e anëtarëve të Komisionit, që më pas të miratohet ky ligj. Qëndrimi im dhe i Qeverisë ishte që neve na duhet një kornize solide, në bazë të të cilës do të zgjidhet një ekip profesional", sqaroi Deskoska.

Ndryshe, opinioni profesional thekson se Ligji i ri antikorrupsionit duhet të konkretizojnë procedurat për kontrollin e pronës së funksionarëve, për shkak se deri më tani, Komisioni vetëm formalisht e ka kryer këtë detyrë. Ata vlerësojnë se me Ligjin e ri, Komisionit duhet ti jepet mundësia që personalisht ti realizoj kontrollet mbi pronën dhe qasjen deri te të gjitha bazat e të dhënave, përfshirë edhe llogaritë bankare të funksionarëve.

Të dhënat e fundit rezultojnë se 25 komuna kanë borxhe minimum nga 1 milion euro dhe maksimum nga 11 milionë euro. Raporti i fundit i Revizionit shtetëror tregon se situata në teren është shumë e rëndë, pasi jo vetëm që kanë borxhe të pashlyera, por edhe më tej futen në borxhe të reja

Koha

Zejnulla VESELI

Shkup, 24 shtator - Edhe përkundër premtimeve të kryeministrit Zoran Zaev për ndihmë ndaj komunave që kanë borxhe të larta dhe punojnë me xhirollogari të mbyllura, asgjë konkrete deri tani nuk është ndërmarrë. Komuna të shumta kanë borxhe të larta madje nga 1 milion euro e deri më 11 milionë euro dhe puna e tyre normale është vështirësuar dukshëm. Tani, gati tre vite pas marrjes së pushtetit, kryeministri Zaev ka ndërruar fjalët. Nëse në 2017 premtoi 120 milionë euro ndihmë për komunat, tani thotë se alternativa e vetme për të ndihmuar në shlyerjen e borxheve të mbetura nga komunat është rishikimi i Buxhetit që duhet të bëhet në muajin tetor të këtij, edhe përkundër faktit se akoma nuk ka një shifër konkrete se sa pushteti

SHPËTIM SHIHET TE RISHIKIMI I BUXHETIT

KRYESON OHRI, TETOVA E DYTA ME BORXHE MË TË LARTA



lokal i detyrohet furnizuesve. Jozyrtarisht, kjo shifër sillet diku mbi 100 milionë euro.

“Zgjidhja përfundimtare për ato komuna që kanë borxhe të mbetura të pashlyera do të realizohet sipas mënyrës që do ta vendos Qeveria, gjegjësisht ndihmës financiare se si të kthehen borxhet e vjetra. Borxhi më i madh i komu-

nave është borxhi që kanë shkollat, kopshtet dhe çerdhet për fëmijë, si dhe institucionet e tjera arsimore. Besoj se me Rebalancin që do të bëhet në tetor, do të sigurohen mjete financiare dhe njëherë e përgjithmonë të zgjidhet ky problem”, deklaroi kryeministri i Qeverisë së Maqedonisë, Zoran Zaev. Në anën tjetër, komunat nuk e-

spektojnë Ligjin për disiplinë financiare, pasi asnjëra nga ato nuk ka publikuar harxhimet, detyrim ky i dalë nga një vendim qeveritar dhe i mbështetur me ligj konkret. Të dhënat e fundit rezultojnë se 25 komuna kanë borxhe minimum nga 1 milion euro dhe maksimum nga 11 milionë euro. Raporti i fundit i Revizionit shtetëror tregon se

situata në teren është shumë e rëndë, pasi jo vetëm që kanë borxhe të pashlyera, por edhe më tej futen në borxhe të reja. Po sipas këtij Raporti, në vitin 2016 komunat kanë borxhe të pashlyera ndaj furnizuesve mbi 80 milionë euro dhe nëse llogariten edhe kamatat, borxhi mund të tejkalojë vlerën mbi 100 milionë euro.

“Ekzistojnë jopërputhshmëri në evidencat e shifrave që kanë komunat dhe Ministria e Financave. Mbi 95 për qind të borxhit është ndaj kompanive vendore, të cilat kanë qenë të angazhuara dhe kanë punuar në emër të komunave”, thuhet në Raportin e Revizionit shtetëror. Sipas këtyre të dhënave, Ohri është komuna që ka borxh më të lartë dhe atë 11 milionë euro. Borxhliu i dytë më i madh është Komuna e Tetovës me 8 milionë euro. Komuna e tretë që ka borxh të lartë është Karposhi me 7.7 milionë euro, e pasuar nga Struga me 3.6 milionë euro, derisa Komuna e Çairit ka borxh në vlerë prej 2.3 milionë euro dhe Kumanovës 2 milionë euro. Ndërkohë, 20 komunat tjera kanë borxhe në vlerë mbi 1 milion euro.

PA PËRFUNDUAR I VJETRI, I VJEN RADHA TË RIUT

KONKURSI I VJETËR ASKUND, AI I 2019-ËS ME KRITERE TË REJA!

Konkursi i ri vjetor për financimin e projekteve me interes nacional në kulturë do të duhet të shpallet këto ditë, madje me disa kriteret dhe kushte të reja konkurrimi, të cilat gjithashtu Ministria e Kulturës ende nuk i ka përfunduar

Koha

Evis HALILI

Shkup, 24 shtator - Edhe pse po afrohet fundi i vitit, Programi vjetor i kulturës akoma nuk është përmbyllur. Në Ministrinë e Kulturës ende nuk kanë përfunduar me ankesat për projektet e refuzuara e të cilat janë ende në shkalën e dytë. Po ashtu, vonesa ka edhe në likuidimin e shumave të akorduara, madje edhe për projekte që janë realizuar në fillim të vitit.

Në ndërkohë, Konkursi i ri vje-

tor për financimin e projekteve me interes nacional në kulturë do të duhet të shpallet këto ditë, madje me disa kriteret dhe kushte të reja konkurrimi, të cilat gjithashtu Ministria e Kulturës ende nuk i ka përfunduar. Nga ky institucion pohojnë se nuk do të ketë ndryshime të mëdha, krahasuar me versionin e vitit të kaluar, me përjashtim të disa veprimtarive. Këtë vit pritet të ketë ndryshime edhe sa i takon komisionet që do të vlerësojnë projektet, kryetarëve dhe anëtarëve të saj, pas skandalit të këtij viti ku për shumë projekte mungoi transparenca në përzgjedhje dhe favorizimi i një grupi të ngushtë shoqatash dhe individësh. “Nuk mund të thuhet se kemi të bëjmë me ndryshime thelbësore, por disa kushte dhe kriteret do të ndryshojnë në disa veprimtari. Këto ditë do të shpallet konkursi, data për të cilin u shty pikërisht për këto arsye”, thonë në kabinetin e ministrit të Kulturës.

Afati ligjor për shpalljen e konkursit është fundit i këtij muaji dhe kohëzgjatja e tij është gati dy

muaj, periudhë kjo kur aplikantët dorëzojnë projektet me të cilat do të konkurrojnë. Konkurrimi zhvillohet në shtatë kategori, artet vizuale, arkitekturë dhe dizajn; folklor muzikë dhe aktivitet skenik-muzikor; veprimtaria dramatike; literatura dhe veprimtaria botuese; mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe veprimtaria ndërkombëtare, si edhe kategoria më e re për projekte interdisciplinare.

Ministria e Kulturës vjet bëri ndryshimet e para, edhe pse kushtet dhe kriteret e konkurrimit kanë ndryshuar në vite. Si pjesë e ndryshimeve që janë trashëguar nga viti

i kaluar janë përjashtimi nga konkurrimi i institucioneve që financohen nga shteti për programin e tyre vjetor, duke i dhënë mundësi vetëm personave fizikë dhe juridikë nga kultura për të aplikuar. Po ashtu edhe dokumentet e aplikimit janë unifikuar për të gjithë sektorët, në mënyrë të atillë që janë eliminuar nënkategoritë, duke thjeshtëzuar formën e konkurrimit, që do të thotë se për çdo veprimtari me konkursin e ri do të ketë vetëm një aplikim, dhe jo më shumë. Konkursi i vitit 2018 u cilësua si i unifikuar dhe i thjeshtëzuar, i formatuar në një mënyrë të atillë që i përshtatej nevojave dhe

kërkesave të atyre që merren me kulturë. Si risi ishte edhe publikimi i shumave të akorduara, krahas projekteve fituese.

Ky vit mund të jetë edhe viti i fundit për termin “interes nacional”, i cili do të zëvendësohet me interes publik. Me Ligjin e ri të kulturës nuk do të miratohen më projekte me interes nacional në kulturë, që do të thotë se mënyra e financimit të projekteve do të bëhet ndryshe. Projekt-ligji për kulturën, që konsiderohet si dokumenti më i rëndësishëm i miratuar në sferën e kulturës, pas Strategjisë nacionale, që prej muajit korrik është në fazën e debatit publik.

IKËN NAFIJA, SËRISH KONKURS PËR DREJTOR TEK NËNË TEREZA

Ministria e Kulturës pritet të shpallë një konkurs të ri për emërimin e drejtorit të Shtëpisë Përkujtimore “Nënë Tereza”. Vendi i mbetur bosh pas dorëheqjes së drejtoreshës së emëruar në këtë post në fillim të muajit shtator, Nafije Selmani, kuadër i Lëvizjes “Besa”, pritet të zëvendësohet me një emër të ri. Për momentin ky institucion drejtohet nga një prej kustosëve Adrijana Jeliq, ndërsa në ueb faqen e këtij institucioni ende si

drejtoreshë figuron emri i Renata Kutera Zdravkovkës, që e drejtoi shtëpinë përkujtimore për gati një dekadë, që nga themelimi, në vitin 2009. Kjo drejtori prej kohësh i ka takuar Bashkimin Demokratik për Integritet, por prej më shumë se katër vitesh, nuk emëroi asnjë drejtor shqiptar. Në Shtëpinë Përkujtimore nuk ka asnjë kustos shqiptar, ndërsa punonjësi i vetëm shqiptar është në dyqanin e suvenirëve.

INCIDENT I ARMATOSUR
NË HASANBEGPlagoset rëndë
22-vjeçari,
dyshohet në
hakmarrje

Shkup, 24 shtator - Lagjen e Hasabengut mbrëmjen e 23 shtatorit e kanë zgjuar të shtënat e armëve. Sipas të dhënave të policisë, cak i sulmit ka qenë personi J.B, 22 vjeçar nga fshati Luboten i Shkupit. Në përshkrimin e ngjarjes thuhet se personi J.B, rreth orës 00:20, ka qenë duke drejtuar veturën e tij në rrugën "Alija Avdoviq". "Nga persona të panjohur është gjuajtur në drejtim të veturës 'Mercedes', të cilën e ka vozitur i dëmtuari J.B. Më pas, ai është transferuar në spitalin e qytetit 'Shën Naum i Ohrit' dhe më pas në qendrën klinike 'Nëna Tereza'. Nga të shtënat me armë, i sulmuari ka marrë plagë në pjesën e gjoksit", thonë nga policia e Shkupit.

Mes tjerash, nga atje shtojnë se janë ndërmarrë të gjitha masat për zbardhjen e rastit. Ndryshe, sipas të dhënave jo zyrtare të policisë kjo zënka zanafillën e ka që në vitin 2015. Raportet e më herëshme të policisë thonë, se me 29 prill të vitit 2015, pjesëtarët e njësitit 'Alfa' në fshatin Luboten e kanë arrestuar T.B. (21) i dyshuar se në datën 16 prill të atij para xhamisë së fshatit e ka vrrarë Xhevahir M (31). Duke sqaruar motivet e vrasjes, MPB kishte njoftuar se te i dyshuari për vepër penale "vrasje" njëkohësisht është gjetur edhe një pushkë automatike AK 47 me kalibër 7.62 mm e cila është gjithashtu lëndë e veprës penale. "Gjykatësi në procedurën paraprake, personit T.B. i shqiptoi paraburgim prej 30 ditëve. MPB paraprakisht informoi se më datën 16 të këtij muaji, rreth orës 19:00, A.M. (23), vëllai i Xhevahir M (31) ka lëvizur me automjet në drejtim të lagjes Radishan, ku në afërsi të qarkores në thirrje telefonike nga miku i tij i cili i kishte ftuar që të dy të shkojnë në fshatin Luboten, ku do të vinte personi me të cilin paraprakisht A.M. ishte grindur, për t'u pajtuar mes vete. Rreth orës 21:30, A.M. dhe Xhevahir M. me automjet ishin drejtuar drejt fshatit Luboten ku në rrugë ishin takuar nga R.J. (58) babai i i denoncuarit, i cili ishte së bashku me djalin e tij J.B. dhe u kishte thënë që të vazhdojnë të vozisin deri te xhamia. Pasi kishin arritur te xhamia, A.M. dhe Xhevahir M. kishin dalë nga automjeti pas çka kishte filluar biseda mes tyre dhe në një moment - nga një rrugë ishte shfaqur T.B. i armatosur dhe pa kurrfarë paramendimi ka shtënë një plumb në drejtim të Xhevahir M., të cilin e kishte goditur në pjesën e kraharorit dhe menjëherë e kishte braktisur vendin e ngjarjes", thuhet në raportin e MPB-së, të datës 29 prill 2015. (O.XH)

KOMUNAT E POLLOGUT ZOTOHEN PËR MBETURINAT

EDHE NJË PREMTIM
PËR DEPONINË RUSINO!Projekti në fjalë pritet të
përfundojë në mesin e vitit
2020 dhe në këtë projekt
janë të kyçura nëntë
komunat e Pollogut

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 24 shtator - Ende nuk është dhënë një afat i saktë për fillimin e rregullimit të deponisë në Rusino. Të gjashtë kryetarët e Komunave të Pollogut, përveç atij të Vrapçishtit, dje kanë filluar përpunimin e detajuar për fazat e ndërtimit të kësaj deponie, e cila vite me radhë po zhagitet. Me mjetet që janë siguruar nga ana e Ambasadës së Zvicrës, kjo deponi duhet që të zgjidh problemin e mbeturinave të tërë rajonin e Pollogut. Edhe kryetarja e Komunës së Tetovës edhe kryetari i Gostivarit, Teuta Arifi dhe Arben Taravari janë shprehur se kanë biseduar me banorët për të përmbushur kërkesat e tyre. Sipas të parës së Tetovës, ndërtimi i deponisë do të zgjidh një problem me dekada që ka regjioni i Pollogut me deponitë e egra.

"Projekti ka dy faza, faza e parë nënkupton studimin e fizibilitetit për sa

i përket trajtimit të mbetjeve dhe masa-ve afatshkurta, veçanërisht linjat e drenazhet e ujërave të zeza që dalin nga deponia dhe ju shkaktojnë dëme qytetarëve të cilët e kanë bërë kërkesë deri tek rajon. Ky projekt kapë vlerën e 7.8 milionë franga zvicerane dhe do jetë në shërbim të të gjithë nëntë komunave të Pollogut", tha Arifi. Ndërkohë, nga Komuna e Gostivarit janë shprehur se sipas analizave që janë bërë, deponia Rusino plotëson të gjitha kushtet për të qenë deponi regionale.

"Deponia Rusino pa dyshim se i plotëson kushtet si deponi regionale. Ne jemi në kontakt të vazhdueshëm me banorët atje, dhe pjesë e zgjidhjes së kërkesave të tyre që janë rreth katër vite dhe këto kërkesa nuk janë marrë parasysh, prandaj edhe jemi në kontakt të vazhdueshëm me ata që të gjejmë zgjidhje të problemit", tha Taravari. Nga Ambasada e Zvicrës kanë theksuar se ky projekt pritet të realizohet me suksese dhe sipas tyre, jo vetëm që do pastrojë ambientin dhe ajrin, por edhe do të përmirësojë kushtet e qytetareve në këtë rajon.

"Procesi është paraparë të implementohet në dy faza. Faza e parë është e paraparë të fillojë me studimin filizibiteti dhe faza e dytë implementimi i projek-

tit për përmirësimin e situatës për mbetjet në këtë rajon. Mendoj se realizimi i projekti është i mirë jo vetëm për pastrimin e ajrit dhe ndotjes, por edhe për përmirësimin e kushteve të qytetarëve të këtij rajoni, dhe shpresoj se ky projekt do të realizohet me suksese", deklaroi ambasadorja e Zvicrës, Sybille Suter. Përndryshe, sipas ministrit të Ekologjisë, Sdulla Duraku, problemi është prej kohës së komunizmit. Ai problemin e mbeturinave e ka lidhur me referendumin duke kërkuar që i njëjti të jetë i suksesshëm. Projekti në fjalë pritet të përfundojë në mesin e vitit 2020 dhe në këtë projekt janë të kyçura nëntë komunat e Pollogut.

Ndërkohë, nga Ministria e Ambientit Jetësor janë shprehur se po punohet në gjetjen e një zgjidhje për të gjitha deponitë në nivel shteti. Në ndërkohë, tashmë një kohë të gjatë të gjitha komunat e Pollogut kanë probleme me mbeturinat, duke filluar nga deponia e egër në Tearcë, problemi me mos marrjen e mbeturinave në Tetovë dhe shumë deponi të tjera në fshatrat e Malësisë së Tetovës, kurse komunat tjera përballen me problemin e mbeturinave ndërtimore, të cilët hidhen vend e pa vend, gjithmonë në mungesë të deponisë për këto lloje mbeturinash.

PREMTIME KA, PUNËT NË TERREN ASKUND

Nxënësit e Studeniçanit në pritje të shkollës së mesme

Takime midis kreut të Studeniçanit dhe ministrit të Arsimit ka pasur, por marrëveshje në letër ende nuk ka!

Shkup, 24 shtator - Rreth 3500 nxënës të Komunës së Studeniçanit edhe këtë vit shkollor janë të obliguar të udhëtojnë rreth 50 kilometra në ditë për vajtje-ardhje

në qytet për të ndjekur mësimin nëpër shkollat e mesme të qytetit. Edhe pse ideja për ndërtimin e një shkolle të mesme në këtë komunë është e kamotshme, asgjë konkrete nuk shihet në terren. Kreu i Studeniçanit, Azem Sadiku, tha për gazetën KOHA se kanë marrë premtime të shumta si nga organizata qeveritare turke "Tika", ashtu edhe nga Ministria e Arsimit, por kjo vazhdon të mbetet një marrëveshje në "ajër". "Komuna e

ka siguruar edhe lejen, edhe vendin edhe projektin... kemi pasur shumë premtime nga Organizata TIKa e Turqisë, ende nuk kemi diçka konkrete, mirëpo me të njëjtën shkolle kemi konkurruar edhe në MASH. Tash në takimin e fundit që kam pas me ministrin na ka dhënë shumë premtime që duhet të parashihen mjete për vitin e ardhshëm që të financohet shkolle e mesme edhe nga MASH. Mirëpo, konkretisht nuk ka dokumentacione...

premtimet janë shumë serioze se MASH-i do të angazhohet dhe do ta merr përsipër edhe do të ndërtohet edhe kjo shkolle e mesme", tha Sadiku. Edhe nga MASH-i konfirmojnë se ministri Arbër Ademi ka pasur takim me kreun e Studeniçanit, duke dhënë sinjale pozitive për këtë projekt.

"Ministri ka pasur takime me kryetarin e Komunës së Studeniçanit, ku është biseduar rreth nevojës për një shkolle të mesme në atë

anë. Mendohet që ky projekt të futet në Buxhetin e vitit 2019 dhe nga viti i ardhshëm, të fillojnë punimet për atë shkolle", thanë nga kabineti i Arbër Ademit. Për ndërtimin e shkollës së mesme në mandatin e kaluar, Sadiku ka siguruar tokën ndërtimore prej 5 mijë metrash katror, ndërsa bazuar në nevojat e banorëve të kësaj ane, mësimi në këtë shkolle parashikohet të realizohet në gjuhën shqipe dhe turke. (A.XH)



**REPUBLIKA E MAQEDONISË
KOMUNA E STRUGËS**

/ SHESHI "NËNË TEREZA" P.N., 6330 STRUGË
Tel. +389 46 781 335, 781 223, 782 015, Faks 781 434
web: struga.gov.mk, e-mail: kryetari@struga.gov.mk, info@struga.gov.mk

**Nr. 10-4114
24.09.2018
STRUGË**

Në bazë të nenit 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 199/2014, , 44/2015 193/2015 31/2016 163/2016 64/18) Kryetari I Komunës së Strugës, e sjell këtë:

L A J M Ë R I M

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të
Komunës së Strugës se shpallet

Thirrje publike për dorëzimin e iniciativës për punim të Planeve urbanistike

Thirrja publike shpallet në pajtim me nenin 21 nga Ligji për planifikim hapësinor dhe urbanistik (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 199/2014 44/2015 193/2015 31/2016 163/2016 64/2018) në kuartalin e dytë për vitin 2018

***Në periudhë prej 31 ditëve**, të gjithë personat e interesuar fizik dhe juridik duhet të dorëzojnë iniciativat për përpunimin e Planeve urbanistike nga neni 7 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik.

***Lëndë e iniciativave** mund të jetë sjellja e Planit të ri urbanistik ose ndryshim dhe plotësim të Planit ekzistues urbanistik ose Dokumentacion planor urbanistik me propozim konkret nga parashtruesi i iniciativës.

***Thirrja publike do të zgjas nga data 01.10.2018 deri në date 01.11.2018 – 31 ditë .**

***Thirrja publike do të publikohet** në faqen e zyrtare të Komunës së Strugës www.struga.gov.mk, në tabelën publikuese të komunës, në sistemin informativ e-urbanizëm, përmes publikimit në informatorin zyrtar të komunës, dhe në një gazetë ditore në gjuhën maqedonase dhe një gazetë ditore në gjuhën shqipe.

***Personat e interesuar fizik dhe juridik** iniciativat t'i dorëzojnë në formë të shkruar përmes arkivit të Komunës së Strugës ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm në afatin e përcaktuar.

***Për të gjitha iniciativat e pranuar** parashtruesit do të informohen në formë të shkruar ose në formë elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm në afat prej 15 ditëve nga përfundimi i afatit për parashtrimin e iniciativave.

***Iniciativat e pranuar** nga Thirrja publike do të përfshihen në programin për punim të planeve urbanistike për Komunën e Strugës për vitin 2018.

***Mjetet** për iniciativat e pranuar për përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm duhet të sigurohen nga parashtruesit e iniciativave – personat fizik ose juridik.

**KOMUNA E STRUGËS
Kryetari i komunës,
Dr. Ramis Merko**

Në bazë të nenit 21 paragrafi 2 e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/141, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, publikon shpallje për punësim të 2 (dy) realizuesve për kohë të pacaktuar për pozitën në vijim:

1. Nëpunës i pavarur profesional – punëtor social
2. Nëpunës i pavarur profesional – jurist

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë (për të gjithë kandidatët):

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- Në mënyrë aktive të një gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët duhet të përbushin kushtet e posaçme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë.

1. Kandidati me numër rendor 1 të ketë së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti filozofik punë sociale dhe politikë sociale pa përvojë pune.
2. Kandidati me numër rendor 2 të ketë së paku 180 kredi sipas SETK Fakulteti i shkencave juridike, pa përvojë pune

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrorin dëshmitë për përbushje të kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Kandidatët për të dyja pozitat e punës, duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:

- Dëshmi të shtetësisë;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit;
- Biografi të shkurtër;
- Letër motivimi.
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për lidhje të marrëdhënies së punës nga doktori specialist – i licencuar për medicinë të punës.
- Certifikatë për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Orari i kohës së punës: orë të punës në javë: 40, koha fleksibile e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 7.30 deri në ora 15.30 dhe 08:30 deri në ora 16:30.

Shuma në të holla e neto pagesës bazë është 23.176,00 denarë

Kandidatët e zgjedhur do të lidhin marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar.

Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është 5 ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar vetë ditën e publikimit). Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përbushin në momentin e paraqitjes.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm duhet të parashtrorin në arkivin e: IP Qendra ndërkomunale për punë sociale – Negotinë, ose përmes postës në adresën në vijim:

rr. "Aco Axhi Iliov" pn, Negotinë
(me shenjë "për shpallje"): nr. 04-184/4.
Personi për kontakt: Drejtor Vijoleta Taseva
Kontakt telefoni: 075/292 904

Fletëparaqitjet e parashtruara pas afatit, jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IP Qendra ndërkomunale
për punë sociale – Negotinë
Drejtor
Vijoleta Taseva

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – teksti i pastruar Gaz, Zyrtare e nr. 167/2015, nenit 5 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të "M-NAV" SHA Shkup, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në "M-NAV" SHA Shkup, dhe Pëlqimeve të marra nga Ministria e financave të RM nr. 18-11184/2 të datës 21.09.2018, "M-NAV" SHA Shkup publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për themelimin të marrëdhënies së punës

Për nevojën për punësim të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. Këshilltar për teknikë të fluturimeve në Sektorin për teknikë të fluturimeve - 1 (një) realizues;

Kandidatët krahas fletëparaqitjes për punësim dhe biografisë së shkurtër (CV), duhet të përbushin kushteve të përgjithshme të parashtrorin dokumentet në vijim:

- certifikatë e lindjes;
- certifikatë e shtetësisë;
- vërtetim nga evidenca e dënimeve të dhënë nga gjykata kompetente;
- vërtetim nga evidenca penale të dhënë nga gjykata kompetente

Dokumentacioni i lartpërmendur duhet të parashtrorin në origjinal ose kopje e vërtetuar në noter.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përbushin edhe kushtet e posaçme:

- Kandidatët për vendin e punës – Këshilltar për teknikë të fluturimeve në Sektorin për teknikë të fluturimeve duhet të kenë të mbaruar: PSP – shkalla VII/1 ose së paku 240 kredi sipas SETK – Fakulteti për elektroteknikë nga sfera e Automatikës. Duhet të ketë së plaku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion. Kandidati duhet të parashtrorin diplomë ose certifikatë për fakultet të mbaruar dhe vërtetim për përvojën e punës (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter). Gjithashtu duhet të ketë edhe kualifikime, aftësi dhe shkathtësi të tjera profesionale, kualitete personale ndërsa posaçërisht: njohje të gjuhës angleze dhe zotërim të aftësive të posaçme - punë me kompjuter.

Orët e punës gjatë javës janë 40 dhe orari i punës është i organizuar me ndërrime. Neto pagesa bazë për kandidatin është: 41.273,00 denarë.

Dokumentet parashtrorin në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, në lokalet e "M-NAV" SHA Shkup në adresën rr. Makedonija nr. 25, objekti L Lazar Pop Trajkov, 1000 Shkup. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të saj në shtypin ditor. Zgjedhja do të realizohet në afat prej 8 ditëve nga dita e kalimit të afatit për paraqitje të kandidatëve.

"M-NAV" SHA Shkup

QYTETI I SHKUPIT

Në bazë të Programit për subvencionimin e amvisërive dhe subjekteve të tjera të Qytetit të Shkupit për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2018 („Lajmëtari zyrtar i Qytetit të Shkupit” nr. 11/18;), Qyteti i Shkupit shpall:

Thirrje publike

për subvencionimin e amvisërive dhe subjekteve të tjera të Qytetit të Shkupit për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2018

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

1.1. Problemi kryesor në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor, me të cilin ballafaqohet Qyteti i Shkupit, është cilësia e keqe i ajrit ambiental në qytet, veçanërisht i grimcave partikulare (PM10 и PM2,5). Një nga arsyt kryesore për emetimin e këtyre grimcave është ngrohja e shtëpive që nuk janë të lidhura me ngrohjen qendrore, para së gjithash për shkak të djegies jo të plotë dhe joadekuatë të drurëve të zjarrit, kualiteti joadekuatë i drurëve dhe mënyra e ruajtjes së tyre dhe përdorimi i stufave të vjetra, të amortizuara dhe të parregullta nga ana teknike, si dhe nga pastrimi jo i rregullt dhe mirëmbajtja e oxhaqeve.

Masa ka si qëllim arritjen e efekteve afatmesme dhe disa efekteve afatgjata:

- Arritja e djegies më të mirë të drurëve,
- Reduktimi i gazrave të dëmshme,
- Reduktimi i blozës,
- Mbrojtja nga zjarri,
- Zvogëlimi i shpenzimeve për ngrohje
- Mbrojtja e mjedisit jetësor, dhe
- Ngritja e vetëdijes publike te qytetarët për nevojën e pastrimit të oxhaqeve.

1.2. Në Thirrjen publike për kompensimin e një pjese të shpenzimeve të amvisërive dhe objekteve të tjera për pastrimin e oxhaqeve mund të marrin pjesë persona fizikë dhe juridikë vendbanimi i të cilëve, përkatësisht selia ndodhet në territorin e Qytetit të Shkupit.

1.3. Thirrja publike zgjat 60 ditë kalendarike nga dita e shpalljes më 22.11.2018 dhe do të realizohet sipas parimit „i ardhuri i parë, shërbehët i pari”.

1.4. Thirrja publike është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk), në mediumet e shtypura dhe elektronike.

2. Kriteret për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

Aplikuesi është e nevojshme të plotësojë kriteret e mëposhtme për pjesëmarrje në thirrjen publike:

- Të jetë banor i qytetit të Shkupit (komunat në qytetin e Shkupit: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj), përkatësisht objekti i personit juridik të jetë në territorin e Qytetit të Shkupit;

- Pastrimi i oxhakut të jetë kryer nga profesionist i punësuar në firmën e regjistruar me shifrën e veprimtarisë 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive, dhe

- Të posedojë vërtetim dhe kupon fiskal për kryerjen e pastrimit të oxhakut me datën e shpalljes së thirrjes publike deri në ditën e përfundimit të thirrjes.

3. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

3.1. Të drejtë për pjesëmarrje në këtë Thirrje publike kanë banorët e qytetit të Shkupit (amvisëritë), si dhe personat juridikë të cilët kanë objekte afariste në komunat: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizari, Qendër, Gjorçe Petrov, Butel, Saraj, të cilët do të pastrojnë oxhakun në vendbanimin e tyre ose objektin afarist në territorin e Qytetit të Shkupit në periudhën nga fillimi i thirrjes publike deri në ditën e përfundimit të thirrjes dhe do të deponojnë kërkesë për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim.

3.2. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe konfirmimin që kriteret për pjesëmarrje janë plotësuar, aplikuesi deri te Qyteti i Shkupit duhet të deponojë dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë për kompensim (Kërkesa mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit ose nga faqja e internetit të Qytetit: www.skopje.gov.mk);
- Dëshmi që është banor në qytetin e Shkupit: Fotokopje e letërnjoftimit ose pasaportë;
- Dëshmi për subjekt afarist: Gjendja aktuale jo më e vjetër se 6 muaj;

- Vërtetim për realizimin e pastrimit të oxhakut, të nënshkruar nga personi ekspert që ka pastruar oxhakun;

- Llogari fiskale nga firma e regjistruar për veprimtarinë pastrim i oxhaqeve (shifra 81.22 në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive). Llogaria fiskale duhet të jetë lëshuar në periudhën nga fillimi i thirrjes publike deri në ditën e përfundimit të thirrjes, dhe

- Fotokopje nga llogaria e transaksionit/xhiro llogaria.

3.3. Vërtetimi për realizimin e shërbimit duhet të jetë lëshuar:

- Për persona fizikë në adresën në të cilën jeton aplikuesi, pikërisht adresa e banimit që është shkruar në letërnjoftim.
- Për personat juridikë në adresën e objektit afarist të subjektit juridik për të cilin vlen gjendja rrjedhëse;

3.4. Vetëm një person nga familja mund të parashtrijë kërkesën për fitim të kompensimit.

3.5. Personat juridikë mund të parashtrijë vetëm një kërkesë.

3.5. Kërkesën për shfrytëzimin e të drejtës për kompensim të një pjese të shpenzimeve së bashku me dokumentacionin,

duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur deri te Qyteti i Shkupit bul. “Ilinden” nr. 82, në arkivin e Qytetit të Shkupit, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në ora 15:00 .

3.6. Në zarin duhet të qëndrojnë: **Thirrje publike për subvencionim të qytetarëve në territorin e Qytetit të Shkupit për pastrimin e oxhaqeve për vitin 2018**

4. Mënyra e realizimit të thirrjes publike

4.1. Kryetari i Qytetit me Aktvendim formon komisionin për realizimin Thirrjes publike.

4.2. Komisioni është i detyruar që ti shqyrtoj kërkesat e arritura dhe dokumentacionet e dorëzuara si shtojca dhe të parashtrijë propozim deri te Kryetari i Qytetit për miratim / mos miratim të kërkesave.

4.3. Për kërkesat e arritura dhe të shqyrtuara, do të drejtohet lista me të dhënat vijuese:

- Emri dhe mbiemri ose titulli i personit juridik dhe adresa,
- Data dhe ora e fletëparaqitjes së dorëzuar për thirrjen publike.

4.5. PAGESA E MJETEVE DO TË REALIZOHET NË MËNYRË SUKESIVE, sipas radhës së fletëparaqitjeve të arritura, pas miratimit të aktvendimit për miratim të kërkesave nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

4.6. Nëse shpenzohen të gjitha mjetet e parapara financiare, Qyteti i Shkupit do ta njoftojë opinionin se thirrja publike ndërpritet para skadimit të periudhës për të cilën ajo është shpallur.

5. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

5.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit, në propozim të Komisionit në afat prej 20 ditëve nga dita e përfundimit të thirrjes publike do të miratoj Aktvendim për miratim të kërkesës dhe për pagesën e mjeteve në neto shumë prej 1.000 denarë për amvisëri, përkatësisht për subjekt juridik, për kërkesit që i kanë plotësuar kriteret e kësaj thirrjeje publike.

5.2. Kryetari i Qytetit të Shkupit në propozim të Komisionit do të miratoj Aktvendim për refuzimi e kërkesës në afat prej 20 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës nëse kërkesi nuk posedon dokumentacion të rregullt dhe të kompletuar.

Në bazë të nenit 18 e Rregullores së Seminarit ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup nr. 02-637 të datës 28.9.2009, nr. 02-515 të datës 5.7.2010, nr. 02-690 të datës 29.11.2010, nr. 02-272 të datës 28.3.2011, nr. 02 – 509/18 të datës 8.6.2012 dhe nr. 02-667/3 të datës 15.7.2015, Drejtoria e rektoratit në mbledhjen e 230 të mbajtur më 21.09.2018 publikon

KONKURS

Për zgjedhje të lektorit të gjuhës maqedonase për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019 dhe 2019/2020 në Universitetin në Sosnovjec, Republika e Polonisë, dhe atë në lektoratin në:

- Sosnovjec pranë Universitetit Shleziski në Katowice, Republika e Polonisë, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;

1. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- Të kenë të mbaruar Fakultetin filologjik, grupi gjuhë maqedonase dhe gjuhët e sllavëve të jugut, grupi i letërsisë maqedonase dhe letërsisë së sllavëve të jugut me gjuhën maqedonase si lëndë të dytë kryesore apo me grupe të lëndëve: gjuha maqedonase bashkëkohore – 6 semestra, historia e gjuhës maqedonase dhe dialektologjia e gjuhës maqedonase;
- Ta zotëroj gjuhën e vendit për të cilën bëhet zgjedhja për lektor në atë masë që do të i mundëson kryerjen me sukses te punëve apo të zotëroj një nga gjuhët botërore, e cila përdoret për mësim në shtetin përkatës;
- Të kenë leje nga organizata në të cilën është i punësuar për pushim të marrëdhënies së punës;
- Zotërimi i gjuhës dëshkohet me vërtetim të dhënë nga Fakulteti filologjik “Blazhe Koneski” në Shkup.

2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës ditore dhe javore dhe orari i kohës së punës është në pajtim me organizimin e vendit të punës në lektoratin pranë Universitetin në Sosnovjec, Republika e Polonisë.

3. Punëtori ka të drejtë në fitim – rrogë, në pajtim me aktet e universitetit, nëse sigurohen mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Për muajt prej tetor deri korrik paguhen 75 % (16.615,00 denarë, neto-shuma, mujore), ndërsa për muajt prej gusht dhe shtator paguhen 100% (21.903,00 denarë , neto-shuma, mujore). Rroga e punëtorit mund të jetë e ndryshueshme.

4. Zgjedhja e lektorit bëhet sipas Rregullores së Seminarit ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase, për punë të lektorëve dhe lektoratëve të gjuhës maqedonase jashtë vendit. Nëse lektori i zgjedhur nuk pranohet nga ana e universitetit për ku është zgjedhur, Universiteti zgjedh tjetër lektor apo ndalet zgjedhja.

Për kandidatën e zgjedhur i cili nuk është në marrëdhënie pune, Universiteti nuk ka për obligim që ta punësoj pas kryerjes së afatit për të cilën zgjidhet lektori.

Kandidatët me fletëparaqitje dorëzojnë: diplomë për fakultet të kryer, biografi të shkurtër, vërtetim për zotërimin e gjuhës së huaj përkatëse dhe leje nga personi juridik për pushim nga marrëdhënia e punës.

5. Dokumentet dorëzohen deri te Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit të konkursit, me shenjë për Seminarin ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase, bul.”Goce Dellçev” nr. 9, fahu post. 576, 1000 Shkup.

Universiteti “Shën. Kirili dhe Metodi” në Shkup

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16), nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 74 të datës 8.05 të datës 2015 Pëlqimit të Ministrisë së Shëndetësisë së R. Maqedonisë nr. 09-5923/2 të datës 20.08.2018 34/14) neneve dhe 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore. Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-10118/2 të datës 06.09.2018, si dhe Vendimit për publikim të Shpalljes publike nr. 04-240/5 të datës 17.09.2018, nga UD Drejtori i IPSh Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod publikon:

SHPLLJE PUBLIKE Për punësim të 2 personave për kohë të pacaktuar

- IPSH Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod ka nevojë për punësim për vendet e punës në vijim:
1 (një) motër medicinale – teknik për kohë të pacaktuar të punës
1 (një) biokimist të diplomuar ose (analist medicinal laboratorik) për kohë të pacaktuar të punës
- Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore:
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- të jetë i moshës së rritur
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- të mos jetë të shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj kandidatët nga pika 1 alineja 1 (motra medicinale) duhet të përmbushin kushte e posaçme në vijim:
- arsim të mesëm të mbaruar të medicinës (PMP shkalla IV),
- provim të dhënë profesional,
- me dhe pa përvojë pune,
Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për motër medicinale është 16.650,00 denarë.
- Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj kandidatët nga pika 1 alineja 2 a) biokimist i diplomuar) duhet të përmbushin kushte e posaçme në vijim:
- arsim sipëror të mbaruar;
Fakulteti matematiko-natyor (drejtimi Biokimia analitike, me së paku 240 kredi sipas SETK)
-me dhe pa përvojë pune
Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për motër medicinale është 23.051,00 denarë.
b) (analist medicinal laboratorik) duhet të përmbushin kushte e posaçme në vijim:
- Shkollë të lartë të mbaruar të medicinës, me së paku 180 kredi sipas SETK
- Provim të dhënë profesional,
- Me dhe pa përvojë pune.
Orari javor i punës është 40 orë. Neto pagesa fillestare për motër medicinale është 22.565,00 denarë.
- Së bashku me fletëparaqitjen, kandidatët për vendi e punës motër medicinale – teknik dhe analist medicinal laboratorik obligohen që të parashtrijë dokumentet në vijim:
- Fletëparaqitje me të dhëna për kontakt
- Biografi të shkurtër (CV)
- Diplomë për sukses mesatar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për shtetësi të Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Dëshmi se nuk u është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.
- Afati për paraqitje në shpallje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i parregulluar nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.
- Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur që i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet testi i pjesës profesionale në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore.
- Fletëparaqitja me tërë dokumentacionin e nevojshëm dhe telefoni për kontakt, parashtrihen në IPSh Shtëpia e shëndetit – Makedonski Brod rr. Vuk Karaxhiq nr. 2, përmes postës ose në arkivin e IPSh Shtëpia e shëndetit Makedonski Brod, me shenjë Për shpallje publike për punësim.

IPSH Shtëpia e shëndetit Makedonski Brod
UD DREJTOR
Dr. Zharko Simeski

Më 30 shtator ti vendos
për ardhmërinë tënde!

**DIL PËR
MAQEDONINË EVROPIANE!**



www.izleziza.mk

Tribunat mbi identitetin, bythecët dhe korrektësia politike!



Nga
Adelina MARKU

Në një tribunë mbi marrëveshjen e fundit me fqiu grek, dallova panelistë lokalë goxha të spikatur. Emra që i njihja që nga fëmijëria ime në fakt! Mundohesha të krahasoj liberalizmin e tyne të sotëm me heshtjen e po të njëjtit liberalizëm kahmot, kur unë isha e vogël! A kishin folur ata njëjtë si sot mbi paragjykimet ndaj Tjetrit/ës, mbi të drejtën e njeriut, mbi identitetin e mitet siç flasin sot këtu? Në fakt jo, pa folur kishin mbetur gjatë kohë! Të pagojët dikur, sot, shkruonin gojë liberalistësh! E kahmot jetojmë sa një grusht dore njerëzish bashkë, të tollovitun e të shtrembnum, të depersonalizim në etnet e rënda që na i mavijosi aparati shtetëror. Ndërsa tema mbi identitetin është kaq e moçme, po aq sa tema mbi Tjetrin/ën e po aq sa tema mbi jetën me Tjetrin/ën që i takon një kulture tjetër!

Sot dëgjoj një mikun tim të ngushtë të më flasë edhe për "trendin" (nuk është fjalë e gjetur mirë në fakt, kjo, fjala "trend"...) e martesave të përziera mes shqiptarëve e maqedonasve, por ama askush nuk e flet këtë dashni dykulturore të përkthyer në përqindje! Thu të ketë mbri 1 përqindshin?! Nuk e di, nuk e trajtojmë si temë ende. Po përse nuk e trajtojmë se?! Ka dy arsye se përse nuk i qasemi kësaj teme: o nuk na pëlqen dhe i ikim me heshtje (të dy palëve nuk iu pëlqen a), o e marim si të qenë - tuj mendu se është trend goxha i lokalizim e prandaj me vetëdije e minimizojmë tuj pas një rezistencë neglizhente ndaj rritjes së këtij fenomeni-po e quaj! Që mos të mjafton vetëm kjo tema e martesave dykulturore, tek tuk më bef edhe ndonjë maqedonas/e që më thotë se ka filluar të mësojë shqipen, e se në esencë i duket gjuhë e bukur, por ah gramatika-goxha e vështirë. Qeshem, e pranoj! Gramatikën - i them - nuk e di as unë, prandaj mos u mërzi! Të njohësh gjuhën e Tjetrit/ës është ndjenjë komoditeti më shumë. Unë e përjetoj si ndjenjë të tillë, më kupton! Nuk do e kisha flatru me epitete tjera të tipit: është kulturë, është civilizim,...sepse fjala "komoditet" përfshin çdo gjë! Tuj qen komod me veten, ti mer vendimin me e pranë ose rrefuzo tjetrin! Kur e pranë - e quajnë civilizim,

kur e refuzon - e quajnë të denjossh me civilizimin! Nuk e çoj më gjatë edhe këtë muhabet, sepse nuk dua t'ia prish entuzjazmin mikut/mikeshës që mëson gjuhën time. Sigurisht që i uroj fat, sepse tuj ma dit gjuhën ka me m'nojft edhe ma mirë! Dhe kjo bën mirë për shëndetin e shoqërisë e shtetit! Nuk habitem ma se përse kaq vonë është kujtu se..., sepse përgjigjen e di, qëndron tek primitivizmi politik që në esencë konjekturohet në potencial për me diskriminu Tjetrin/ën! Mua, me një fajël, Ty gjithashtu! Shkoi edhe kjo!

Saças verejta se të gjitha këto monologje, pra mbi martesat e përziera, mbi mësimin e gjuhës sime nga një maqedonas/e, mbi dozën e civilizimit etj etje po i bluaja në mendje e me veten tuj pa e dëgju tribinën ku folësit gjëmonin afirmativisht mbi leximin e marrëveshjes me fqiu grek! Hej, për një çast vëreja se në tribinë nuk kishte asnjë folës shqiptar!!! Po pse kështu?! S'dij nëse m'u duk ky realitet asimetrik...(sepse asimetrik ka qenë gjithmonë në këtë drejtim në fakt, prandaj nuk mund të më duket edhe më shumë asimetrik...asimetria është asimetri!) por më shumë iu habita vetes se përse nuk më kish ra në sy kjo "mungesë" që në fillim të tribinës! Pastaj përsëri fillova me monologjet e brendshme sepse ky fakt

m'u duk shqetsus! Të jem rrehatuar edhe unë me idenë se për ca gjana ne shqiptarët nuk duhet të flasim sepse (...nuk jemi të thirrur me fol...), hmmm e se do dilnim politikisht jokorrekt ndaj bashkshetetasve tanë maqedonas? Ose të kem rrënë rrehat e në letargji edhe unë tuj mendu se ky nuk o problem yni në fakt e se nuk duhemi mar me të...e për të qenë politikisht korrekt duhet me u bo zombi? Ose na mjaftojnë megafonin shqiptarë të qeverisë që janë këshilldhënës të kryeministrit për çështje strategjike, do emra "arkaikë" këta do thoja që i shoh të çesin biber në çdo manxhe tash e 50 vjet të miat e nga të cilëtdorën në zemër, s'dij çfar hajri plus mundet me pas i pari qeverisë e tek synon në kohë moderne me arkaikët bisht?! Pthuuu, n'dreq o punë! M'u desht me fol, sepse tribina monoetnike mbi çështje të shtetit në të cilin jam edhe unë taksapaguse por dhe mjaft intelektprurse, ishte aspak politikisht korrekte! Reagimi im doli pa e menduar gjatë! Fola si votuese potenciale PRO referendumit! Por ...nuk më mjaftoi kjo, fola si një qytetare e cila e sheh doemosdonë e madhe që pjesë e tribinës në këtë temë të jetë shqiptari njashtu. Përse? Dy arsye dhe atë shumë të forta: e para, sqarova mbi identitetin poashtu të padiskutueshëm kulturor të shqiptarëve që bota i njeh si: shqip-

tarë, arvanitë, arnautë, arbëreshë, albanas, ...etj etje, ndërsa ne komodshëm flasim në një gjuhë e thirremi në një histori. Ky kontinuitet kulturor ka domethanie identitare historike për të gjithë ne që gjëmojmë në gjuhën shqipe! Ju thash se ngjizja e ngjitja e identitetit kulturor me shtetin nuk është kategori e shëndetshme, sepse është identiteti kulturor dimension i gjallë e organik, ndërsa shteti është konstrukcion politik! Kufinj të janë konstrukcione politike, 'kapish', ndërsa identiteti kulturor është organik që definohet nga mendja. Kur mendja harron të zhvillojë identitetin kulturor, asimilohesh nga vetëakulturimi. Ju thash se traumën e maqedonasve e njoh, nuk mundem t'a ndjej, por mundem t'a identifikoj, sepse, me këtë marrëveshje ç'kapet identiteti kulturor i maqedonasve nga konstrukcioni Shtet dhe këtë ç'kapje maqedonasit etnikë nuk duhen t'a kuptojnë si humbje, përkundrazi, duhen t'a përjetojnë si liri! E dyta, iu thash se kanë gabuar që nuk kanë ftuar shqiptarë në tribinë; Ne kemi shumëçka t'ju mësojmë bashkëkombasve tanë mbi alfabetin dhe rritën e identitetit! Përjashtimi ose neglizhenca të themi nuk flet për kujdesin ndaj Tjetrit/ës. E ai/ajo që nuk kujdeset për Tjetrin/ën, si i/e vetëm/e, fashitet me kohë! Pastaj më kot kërkoni kujdes nga fqiu përderisa

nuk respekton mjaftueshëm atë që keni në shtëpi! - "full stop!"

Hmmm, pasoi një heshtje pas reagimit tim! Paj, çka tjetër mund të pasonte se! Reagimi im ishte si në teatrin e Stanislavskit! E quajnë, efekt i Stanislavskit! Buummm, të shkallamit nga fokusi parësor, faaap të kthen në realitet! Masnej heshtja është aprovim, apo! Oh dhe saças, nga publiku ngritnë duar edhe shumë kolegë të mij! Ishin shqiptarë, kolegë të mij ...me sa duket iu dhash zemër dhe secili nga ta foli me empati mbi çështjen e marrëveshjes me Greqinë! Dhe kështu tribina monoetnike, u shndrua në gjithetnike! Hej, a e sheh se sa pak duheshka! Fol...mos u koçit, dil nga lëkura e t'diskriminimit, ndjeje erotikën e paraqitjes tande t'sinqertë dhe fol...mos prit të të ftojne!


Sot, tek po shkruaj këtë tekst, kuptoj se vetëeliminimi është një paranojë në fakt e se është një kategori mentale që është padiskutim rezultat i diskriminimit dhe mospranimit të gjatë. Ne shqiptarët edhe jemi vetëeliminuar... hmmm dhe kjo do shumë kohë për t'u sqaru se përse! Këtë kapitull që e kena kalu deri më tani po e quaj: heshtje nga diskriminimi dhe mospranimi! Por, kaptina e re duhet të na gjejë të zëshëm e plot libido, pa asnjë fije doze korrektësie politike! Biles duhet thënë se çdo gjë në këtë shtet, e ndjej njësoj si tjetri, për më shumë madje i jap edhe vullë ekzistencialiste! Të jesh politikisht korrekt është njësoj si ata "arkaikët" këshilltarë që punojnë te Kryeministri. Është një si tip filozofie "bythore" e trajtuar me përpikmëri nga "bythecët ideologjikë arkaikë".

Pastaj Donald Trump ka një fjalë gjigande mbi korrektësinë politike, thotë: "mendoj se problemin e madh që e ka vendi im është se gjatë kohë ka folur me gjuhën e korrektësisë politike. Kam qenë i sfiduar nga shumë njerëz e nga mendime të ndryshme dhe të jem i sinqertë nuk kam kohë për plotësisht korrektësi politike.

Dhe të jem i sinqertë me ju, as ky vend s'ka më kohë!" - full stop, again! Sepse, do shtoja unë më pastaj, nuk ka një gjë të tillë si: luftë politikisht korrekte!

(Autorja është kolumniste e rregullt e gazetës KOHA)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtyp dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 24 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirrollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I TEATRIT ÇEL SIPARIN E SHFAQJEVE TEK "ARTURBINA"

Akademisë Evropiane të Filmit i shtohen edhe tre anëtarë nga Kosova

Ismet Sijarina, Sevdije Kastrati dhe Fatmir Spahiu janë tre anëtarët e rinj që kanë marrë ftesë nga EFA Regjisori Ismet Sijarina, drejtoresha e fotografisë Sevdije Kastrati dhe producenti e aktori i njohur Fatmir Spahiu janë tre anëtarët e rinj nga Kosova që kanë marrë ftesë nga Akademia Evropiane e Filmit të jenë pjesë e saj. Kështu u bë e ditur përmes një njoftimi nga Qendra Kinematografike e Kosovës në rrjetin social Facebook, ku thuhet se kjo ftesë vie pas suksesit të filmit "Nëntor i Ftohtë" i cili do të shfaqet premierë botërore javën që vjen në festivalin e famshëm të filmit në San Sebastian në Spanjë. "Në rrafshin personal dhe profesional anëtarësimi në EFA është një arritje e madhe. Është nderë të jesh pjesë e elitës kinematografike evropiane. E falenderoj Qendrën Kinematografike të Kosovës, për nominimin që më ka bërë" u shpreh regjisori Sijarina. Ndërkaq aktori Spahiu tha se ndjehet i privilegjuar. "Kjo ftesë është shpërblym për punën dhe sfidat që kanë profesionet tona, jam shumë i lumtur dhe ndjehem i privilegjuar", tha ai. Akademia Evropiane e Filmit është themeluar në vitin 1989 me drejtorin e parë Ingmar Bergman bashkë me anëtarët tjerë themelues si Pedro Almodovar, Lindsay Anderson, Bernardo Bertolucci, Sir Ben Kingsley, Andrzej Wajda, Wim Wenders etj. Ceremonia e Çmimeve Evropiane të Filmit vijon të mbahet në Sevilla (Andalusia) të Spanjës në dhjetor të këtij viti. EFA ka mbi 3,500 anëtarë nga mbarë Evropa, ku prej tyre Kosova ka 25 anëtarë.

Skena e re "arTurbina" hapi dje dyert për të mirëpritur Festivalin Mbarëkombëtar të Teatrit, ngjarja më e rëndësishme teatrore e vitit, ku në datat 23-30 Shtator, do të ngjiten në skenë 14 trupa teatrale nga të gjitha trevat shqiptare. Në hapjen e Festivalit, kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj tha se investimi për "arTurbinën" ka një rëndësi të veçantë për qytetin.

"Jam shumë i lumtur që ne, si Bashki e Tiranës, iu bashkuam financimit për kthimin e festivalit. E dini fare mirë, sa herë që do të bësh diçka ndryshe, has atë valën e parë të histerisë, që thonë: Ore, njerëzit s'kanë bukë të hanë, ç'është kjo që financojmë teatro? Por, unë besoj se duhet t'i përgjigjemi një pyetje: Njerëzit jetojnë vetëm me bukë? Pra, a është teatri gjithashtu ushqim? A është muzika ushqim? Po filmi? Unë besoj se në një qytet të mirë do të duhet të ketë një menu që mbush jo vetëm stomakun, por edhe shpirtin, kokën, me libra, aktivitete e festivale", tha Veliaj.

Ai nënvizoi se kryeqyteti do të ketë edhe një godinë të re për Teatrin Kombëtar dhe i ftoi të gjithë të lënë pas histerinë, për t'i hapur rrugë zhvillimit. Veliaj shprehu bindjen se ashtu si "arTurbina", edhe godina e re e Teatrit Kombëtar do të ketë një njëjtin sukses. "Ka ardhur koha që të jemi më pak



të marrosur, më pak histerikë, më pak entuziastë për Ilaçin e tullën dhe më shumë të frymëzuar nga arsyeja e vërtetë se pse ne po i bëjmë këto ndërtesa. Bëhen për njerëzit, për t'u shijuar e përjetuar nga njerëzit, për të frymëzuar njerëzit. Me më pak shqetësim për Ilaçin, tullat, arkitektët e inxhinierët, për tallashin dhe gjithë vjetërsirat dhe me më shumë angazhim, të mund të financojmë teatro si ky që do shohim sot", deklaroi Veliaj.

Falë një kalendari të detajuar,

të ngjeshur me aktivitete nga Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Kulturës, Tirana është kthyer në një qendër arti, duke arritur gjer në 700 evente në vit. "Në një kilometër katror hapësirë po ndodhin disa gjëra: një event në sheshin "Skënderbej", një event tjetër tek Amfiteatri i Liqenit, një tjetër aktivitet filmash te Pazari i Ri e kështu me radhë; në qoftë se unë do të kisha një ëndërr për të vizatuar se ç'mund të ishte qyteti ynë, ai do të ishte i mbushur me aktivitete të tilla", tha Veliaj.

Ky festival e nisi rrugëtimin e tij një javor me komedinë shqiptare "TAG". TAG është një realizim tërësisht shqiptar, i prodhuar nga Bashkim Hoxha në bashkëpunim me Andia Xhungën si regjisore, Genc Shkodranin si scenograf, Berina Kokonën si kostumografe dhe Agim Krajken dhe Sajmir Çilin si realizues të muzikës. Por, kjo nuk do të jetë shfaqja e vetme, pasi edhe 13 shfaqje të tjera nga trupa të të gjitha trojeve shqiptare do të jenë pjesë e këtij festivali të rëndësishëm kulturor. (Gazeta Shqip)

Adhuresit e filmit dynden në festivalin e Sarajevës



Adhuresit e filmit janë dyndur në Festivalin e Filmit Dokumentar që është mbajtur në Sarajevë. Drejtori i këtij festivali Edhem Foco, ka thënë se është i kënaqur me interesimin e pjesëmarrësve. "Besoj se shumë shpejtë shpejtë, festivali do të zërë një vend të rëndësishëm në Evropë". Shumë pjesëmarrës nga ballkani dhe pjesa tjetër e evropës

morën pjesë në ceremoninë e hapjes së festivalit, e cila po mbahet për herë të parë, në Sarajevë dhe do të vazhdojë deri më 25 shtator. Do të garojnë gjithsej 15 dokumentarë dhe do të prezantohen tre çmime. Festivali synon të mbështesë dokumentarët dhe shkrimtarët duke u përqëndruar në vlerat universale humanitare dhe çështjet sociale.

"Si ta vrasim Presidentin", me 29 shtator në Teatrin Kombëtar

Në Teatrin Kombëtar të Kosovës do të rikthehet shfaqja, "Si ta vrasim Presidentin". Kjo shfaqje pritet të shfaqet më 29 shtator ditën kur qytetarët do të protestojnë kundër presidentit, Hashim Thaçi.

"Ta vrasim Presidentin" është dramë që flet për gjendjen e një vendi të Evropës që gjendet në tranzicion, andaj si e tillë edhe është lehtë e adaptueshme në Teatrin Kombëtar të Kosovës. Heroi i kësaj shfaqje vjen përmes personazhit Igor 31 vjeç, i cili është kundër globalizimit dhe është i përgatitur të luftojë në çfarëdo forme për një botë të re.

Vëllai i tij Robert, i cili është katërmbëdhjetë vjet më i vjetër, ka luftuar kundër socializmi derisa ishte i ri, por tani është shndërruar



në konformist. Igor kthehet në atdheun e tij me të fejuarën e tij, Maria. Vëllai i tij Robert dhe gruaja e Robertit Stella, nuk i pëlqejnë pikëpamjet radikale të Igorit për globalizimin dhe anti-globalizimin, nga frika se kjo mund të kërcënojë karrierën e tyre dhe mirëqenien e familjes së tyre.

IMAZHI POETIK SI QENËSI E POZISË

(Përkitazi me vëllimin poetik “Era përkund pikëllimin e luleve”, përzgjedhje poezish nga Frederik Rreshpja, botuar nga shtëpia botuese “Beqir Musliu”, Gjilan)

Anton Nikë Berisha

Poezia që përftoi Frederik Rreshpja, sidomos pjesa më cilësore e saj e përfshirë në këtë zgjedhje, e përcakton atë në mënyrën me të mirëfillt, përkatësisht është dëshmia më e mire e qenësisë dhe e veçantisë së tij si poet dhe e pasurisë së tij shpirtërore.

Frederik Rreshpja hyn në rrethin e ngushtë të poetëve tanë bashkëkohorë që, nga njëra anë, mendimi i tij për artin e fjalës, për poezinë dhe, nga ana tjetër, teksti poetik (poezia) që e krijon, përkujnë e njëjtësohen në disa rrafshë e përbërës. Në mënyrë të veçantë teksti që ai e përftoi, e përcakton dhe e sqaron thellësisht parimin e tij poetik dhe gjakimin e tij si krijues.

Rreshpja synon të jetë i kursyer kur e harton tekstin poetik; të përfshijë sa më shumë mendim me sa më pak material gjuhësor shprehës. Si kursimtar synonte t’i përngjante Poradecit: “Më pëlqen të vazhdojë rrugën e Poradecit (është më i larti)”. Stili i mëvetësishëm nënkupton gjuhën poetike të mëvetësishme e të pasur. Poezia nuk mund të shkruhet me gjuhën e rëndomtë ose

siç theksonte Rreshpja, me gjuhën që nuk përkon me natyrën e poezisë: “(...)ca libra të shkruar me gjuhë kuzhine”.

Lidhja dhe njësimi i Rreshpjes me poezinë s’ka qenë e njëjtë në rrjedhë të kohëve; në moshë të pjekur e ka përjetuar dhe e ka krijuar poezinë ndryshe në krahasim me kohën e fillimit: “Kam vënë re se tani poezinë e shkruaj më me pasion se kur kam qenë 20 vjeç”.

Poezia e Rreshpjes është poezi e vetmisë shpirtërore, që i kundërvihet edhe vetë vetmisë si dukuri; është poezi e shqetësimit, e dhembjes. Këtë e dëshmojnë edhe fjalët kryesore që përdor: vetmia, vjeshta, dhembja, vdekja, Itaka, mjegulla, shiu, hëna, gjethet, deti etj. Rreshpja vështron edhe dukuri të së kaluarës, figura të shquara historike (Skënderbeu, Fishta), qytetin e lindjes, Shkodrën e ndonjë tjetër.


Bota poetike e Rreshpjes s’është botë ëndërrash, nuk është botë e fantazisë, që ka qëllim fantazinë vetë, po botë e përfytyrimeve shqetësuese e tronditëse; e tundimeve dhe e pësimeve herë-herë të skajshme shpirtërore, që përligjen nga

teksti i shtjelluar me përkushtim e dije; është vetëdija e poetit: vetë figurën e tij.

Itaka shpirtërore e Rreshpjes, është të qenit, etja e tij, frymëmarrja, të lëvizurit, të menduarit, është poezia që e krijon. Së këndejmi, brenda tij fillon gjallimi i çdo gjëje, që ndërtohet sipas parimeve të botës së brendshme, ku thyhen parimet e veprimtimit konkret (pse jo edhe të menduarit). Pra, mesazhet tronditëse krijohen edhe marrin jetë paraprakisht në botën e brendshme të poetit; aty ngjizet dhe përligjet gjithçka dhe si e tillë shtjellohet dhe shprehet përmes gjuhës dhe tablove poetike.

Në poezinë e Rreshpjes dhembja ka përmasë të gjerë, shkaktohet nga vetmia dhe vuajtjet që i përjeton dhe i ndan ai: “Që edhe unë jam në këtë botë pa fole”, apo “Si na erdhi kjo stinë me emrin haririm!”, “Ka mbirë bari nga sytë e tu” (Elegji për nënën).

Në poezi Rreshpja nuk përdor shprehje vargje të natyrës retorike, klithje, britma, nuk lëshon kushtrim, po përmes gjuhës dhe sistemit të veçantë të të shprehurit e ndërton realitetin poetik, përfiton pamje



(imazhe), tablo që e ballfaqojnë së pari me vetveten, me kohën, me dhunën që i shkakton njëmendësia (kulturore dhe politike) që si e tillë mund të bëhet edhe pjesë e botës së tjetrit: “Dashuria ime mund të bëhej çati e tërë botës” (Mos e mallo me ndarje këtë natë).

Në rrafshin e dukurisë—vepër e hapur—poezia e Frederik Rreshpjes hyn në rrethin më të ngushtë të mundshëm të poezisë sonë bashkëkohore që e përligj atë në mënyrë më të thellë.

(Fragment nga parathënia e librit)

“DITURIJA” E LUMO SKËNDOS NË DUART E LEXUESIT

“Na duhen libra”, shkruante një shekull më parë Mid’hat Frashëri, eruditi me një mbiemër të madh, që po aq të madhe do ta kishte dhe trashëgiminë e emrit të tij.



“Ishte një kohë kur qaheshim se kombi ynë s’kish mëmëdhetari, s’kish dashuri për kombin, as ndjenja mëmëdhetare. Sot jemi të lumtur duke parë se dashuri e mëmëdheut dhe e kombit është e gjallë dhe e fortë në zemrat e djemve të Shqipërisë. Të zgjuarit e një kombi dhe të lulëzuarit e tij në këtë udhë të bukur të përparimit bëhet me dituri e me mësim. Dhe nga më të mëdhatë nevoja, mbase më e madhja dhe më e shtrënguar është ajo që kemi për libra shqip”, thoshte ai asokohe në nismën e tij të re letrare.

Kështu niste udhën revista “Diturija” me drejtonjës, siç i pëlqente të shkruante në faqe të parë, atë vetë, të njohur si Lumo Skëndo.

Një revistë që do t’u mbijetonte për dy dhjetëvjeçarë peripecive, botuar gjithsesi me shumë ndërprerje, për ta riparë dritën e botimit pas një shekulli falë një mun-

di intelektual, e më shumë se kaq. Ribotuar si për të plotësuar thirrjen e Lumo Skëndos për më shumë dituri e për më shumë libra shqip.

Përmbledhja e revistës “Diturija” vjen si një bashkëpunim mes Fondacionit “ALSAR” dhe Bibliotekës Kombëtare, me rastin e 110-vjetorit të Kongresit të Manastirit. Duke cituar parathënien e përmbledhjes, revista “Diturija” përbën një monument kulture të pasohq në thesarin e dijes dhe kulturës të trashëguar përgjatë jetës së kombit tonë.

“Diturija” është vetë Lumo

Skëndo, çmbante brenda tij ai njeri, reflektues i pasionit me të cilin i jepej fushës së letrave. Veç zënies me shkrimin dhe përgatitjen e materialeve, atij i duhej të merrej dhe me gjetjen e mjeteve financiare për të mbajtur revistën. Aq sa do detyrohej të shkruante në të nganjëherë dhe ashpër, i zhgënjyer prej atyre që e kishin lënë në baltë. Kalvari i mbijetesës së revistës është i njëjtë me atë të shumë sipërmarrjeve të ngjashme sot.

“Kur vendosa të botoj DITURINË, desha më parë të siguroj jetën e saj materiale... Mjerisht, prej atyre që më dhanë fjalën dhe

nënshkrimin, më e shumta ka neglizhuar të na dërgojë pajtimin. Gjyshërit tanë e kishin zakon ta mbajnë besën vetëm me një fjalë. Kujtoja se një fjalë e dhënë me nënshkrim do të ishte besë më e fortë. Në qoftë se vazhdon moskujdesja, kam frikë se DITURIJA do të mbetet pa dalë...” Kështu e shprehte hallin për revistën Lumo Skëndo teksa ishte vetëm në numrin e tretë të saj.

Revista do të botohej më së pari në Selanik, në nisje të 1909-s, si një e përmuajshme: “E përkohëshme shqip literare dhe diturake.” Stacioni tjetër do të ishte Bukureshti, ku do të dilnin numrat e motit të dytë të botimit, me një rinisje pas shtatë vitesh. Një tjetër ndërprerje e gjatë për shkak të rrethanave të kohës do ta zhvendoste më tutje botimin në Tiranë, nga 1926-ta në 1929-n. Botimi i sotëm i përmbledhjes së revistës “Diturija” është në dy vëllime. Periudha nga janari i 1909-s në tetorin e 1927-s ka zënë vend në vëllimin e parë; vëllimi i dytë përmbledh materialin e revistës të periudhës mes nëntorit të 1927-s dhe dhjetorit të 1929-s.

Tematika është e gjerë të “Diturija”, nga çështjet gjuhësore te por-

trete figurash të njohura, nga njohja me aktivitetin e shqiptarëve në Rumani te historiku i shqiptarëve në Greqi, Itali, nga rrëfimet për udhëtarët e huaj në Shqipëri te poezitë, nga fjalëtoret te kënga popullore, nga ca letra interesante te një rubrikë me kuriozitete. Një varg emrash të njohur, thotë parathënia, ku radhiten Pedersen, Jokl, Borgia, Weigand, Roques, Pop, Sufllay, Pekmezi, K. Gurakuqi, A. Xhuvani, M. Logoreci, P. Ikonomi, mes të tjerëve, i kanë dhënë kësaj reviste dinjitetin e një katedre të mirëfilltë albanologjike.

“Diturija”, me “këndonjësit” e saj një shekull më parë, na bën dhe ne sot të tillë. Në të mund të kuptojmë më mirë natyrën e botuesit të saj, mund të kuptojmë më mirë frymën e kohës. Sa mirë për atë që do të ketë fatin ta ketë këtë “dituri” në dorë e të bëhet “këndonjësi” i saj!

Ky botim është më e fundit punë e përfunduar me sukses nga Fondacioni “ALSAR” në këtë fushë. Institucioni në fjalë pritet të sjellë gjer në fund të vitit dhe 13 tituj të tjerë, mes të cilëve një botim të tillë si, “Bibliografia retrospektive e librit shqip”. /Te sheshi

Dialogut i mungon legjitimiteti demokratik

Procesi i dialogut Kosovë-Serbi ka mungesë të legjitimitetit demokratik. Kështu ka thënë ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, në një intervistë dhënë "Kohës Ditore" disa ditë para largimit të tij nga posti në Prishtinë. "Mendoj se është punë e Kuvendit që të sigurojë legjitimitet demokratik. Kuvendi nuk ka qenë në gjendje të sigurojë 61 vota për asgjë që lidhet me dialogun, fatkeqësisht", ka thënë Delawie, duke theksuar se "çdo zgjidhje që del prej dialogut e që nuk ka ndonjë farë legjitimiteti demokratik do ta ketë të vështirë të pranohet". Delawie, i cili ka kaluar tre vjet në Kosovë, ka sqaruar edhe pozicionin e SHBA-së ndaj zgjidhjes së përfolur mes Kosovës dhe Serbisë, përkatesisht mes presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij serb, Aleksandar Vuçiq, e që thuhet se është një lloj këmbimi i territoreve mes të dyja vendeve. Delawie në intervistë ka folur edhe për rëndësinë e sundimit të ligjit për Kosovën, progresin e arritur, por edhe sfidat e mbetura. Ai, po ashtu, ka folur edhe për procesin e transformimit të FSK-së në ushtri dhe vendimit të Qeverisë që kjo të bëhet përmes ligjit dhe jo Kushtetutës. Ambasadori amerikan foli edhe për rastin e "veteranëve të rrejtshëm", duke kërkuar që debati të mos bëhet për prokurorin e rastit, por të orientohet rreth esencës, që është përgjegjësia ligjore e Komisionit qeveritar.

Vuçiqi e Putini flasin për Kosovën më 2 tetor



Kryetari i Serbisë Aleksandar Vuçiq, siç njofton tanjug, më 2 tetor në Moskë do të takohet me kryetarin e Rusisë Vladimir Putin. Ky do të jetë takimi i 13-të ndërmjet Vuçiqit e Putinit dhe në të pritët të flitet për Kosovën. Për herë të fundit kryetari serb dhe ai rus ata janë takuar në muajin maj të këtij viti kur biseduan për Kosovën dhe furnizimin me pajisje ushtarake ruse. Mediat serbe më herë kanë njoftuar se kryetari rus Vladimir Putin së shpejti do ta vizitojë Beogradin.

Pse presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq ka refuzuar të shkojë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB? Dhe cilat janë shkaqet për zemërimin e tij?

Presidenti i Serbisë Aleksandar Vuçiq ka vendosur që të fillojë një fazë të re në raportet me bashkësinë ndërkombëtare, që mund të quhet edhe si bojkotim i heshtur i Brukselit dhe Uashingtonit. Vendimin e ka marrë Vuçiqi, por e ka publikuar udhëheqësi i zyrës për Kosovë Marko Gjuriq, i cili tha se Brukseli duhet të presë pak për vizitën e ardhshme të Vuçiqit atje. Ndërkohë që Vuçiq nuk do të marrë pjesë as në Asamblenë e Përgjithshme të OKB. Në Nju Jork do të udhëtojë kryeministrja Ana Brnabiq. Gjuriq shpjegoi se Vuçiqi ka ofruar disa zgjidhje për çështjen e Kosovës, por atë e kanë kritikuar shumë për këto ide. Gjuriq tha se presidenti i Serbisë është përballur me heshtje, me distancim nga idetë e tij, e madje edhe "me sulme të tmerrshme", ndaj Gjuriq tha se në Bruksel "tani do të presin edhe ca kohë deri sa Vuçiq të shkojë në takimin e ardhshëm".

PSE ËSHTË ZEMËRUAR PRESIDENTI?

Nëse zemërimi i presidentit të Serbisë Vuçiq ndërlidhet me idetë e tija për përkufizim me Kosovën, atëherë nuk dihet sakt se për cilat sulme të bashkësisë ndërkombëtare e ka fjalën Gjuriq. Ideja për përkufizimin, ndarjen e territoreve apo shkëmbimin e tyre, nuk është pritur me ndonjë entuziazëm të madh në disa vende perëndimore, por është tërësisht e tepruar të thuhet se për këto ide Vuçiqi "është përballur me sulmet më të tmerrshme". Në disa vende ka pasur madje mirëkuptim për idetë e Vuçiqit.

Një numër i madh i diplomatëve evropianë ka bërë të ditur - ndonëse me shumë kujdes - se janë të pranueshme marrëveshjet që arrihen mes Prishtinës dhe Beogradit, e shikuar nga shkrimet e mediave serbe, më së paku kundërshtime për këto ide ka pasur në SHBA. Mediat serbe kanë bërë madje gara me shkrimet se administrata amerikane e ka ndryshuar qëndrimin dhe se ajo nuk ka asgjë kundër zgjidhjeve të cilat do të nënkuptonin ndonjë lloj ndarjeje apo përkufizimi.

Po pse është i zemëruar Vuçiqi pra? Naim Leo Beshiri, drejtor i Institutit për Çështje Evropiane thotë se "Vuçiqi zemërohet tepër shpesh dhe ne shpesh nuk e dimë fare pse është zemëruar presidenti. Skenarë të ndryshëm për zgjidhjen e çështjes së Kosovës janë paraqitur në opinionin, por ne

NUK TË DËGJON KUSH? VUÇIQ MOS U ZEMËRO KAQ



kurrë nuk kemi marrë ndonjë konfirmim zyrtar se cili është propozimi i autoriteteve serbe. Ne vetëm dimë se Serbisë nuk i përgjigjet status quo-ja, që do të thotë se ajo angazhohet për përkufizim, korigjimin e kufijve, shkëmbimin e territoreve - por përgjigjen e saktë nuk e kemi marrë kurrë".

"Ndaj kam frikë se fjalët e Gjuriqit janë vetëm një truk për opinionin e brendshëm. Kjo duhet të bindë qytetarët serbë se Vuçiqi ka bërë gjithçka brenda mundësive të tij, por bashkësia ndërkombëtare nuk është e gatshme t'i pranojë kërkesat tona. Ndaj kur të vijë koha e nënshkrimit të marrëveshjes me Kosovën do të kërkojë mbështetjen e qytetarëve në referendum, sepse ndonjë zgjidhje tjetër nuk ka qenë e mundur", mendon Beshiri.

BRUKSELI NË AKULL

Gazetari i revistës NIN, Vladan Marjanoviq thotë se Gjuriq shpesh tingëllon si një komik stand-up dhe si e tillë mund të konsiderohet edhe deklarata e tij. "Thuhet se Bashkimin Evropian do t'i jepet kohë e mjaftueshme që të kuptojë se sa ka gabuar ndaj Vuçiqit dhe qën-

drimit të tij heroik për 'zgjidhjen' e çështjes së Kosovës, ndonëse Vuçiqi e ka pranuar në fjalimin e tij në Mitrovicë se ai nuk ka ndonjë zgjidhje. E kur BE ta kuptojë gabimin, atëherë Vuçiqi do të mëshirojë dhe do të shkojë në bisedime. Ndërkohë autoritetet serbe do të bartin me krenari gjithë këtë mllef ndaj mosmirëkuptimit të ideve të Vuçiqit në Bruksel dhe Berlin", thotë Marjanoviq. Është shumë e qartë që Gjuriq në këtë rast është vetëm bartës i fjalëve të Vuçiqit. Por duket qartë se Vuçiqi është kaq i zemëruar me përdimin sa që vendimin e tij e ka kumtuar dikush tjetër, e jo ai vet. Vladan Marjanoviq thotë se me këtë vendim Beogradi sugjeron se "ka qenë i gatshëm për kompromise, por tani për një kohë të caktuar do të ketë qëndrime shumë të ngurta. Kjo nënkupton mundësinë e vazhdimit të mos zgjidhjes së çështjes së Kosovës - që sipas të gjitha gjasave është edhe qëllimi përfundimtar".

ZEMËRIMI ËSHTË DËSHMI I (PA)AFTËSISË

Aleksandar Vuçiq ka vendosur të mbaj inat me bashkësinë ndërkombëtare, por qytetarët e

Serbisë më shumë janë të interesuar të dinë se çfarë mund të arrihet me këtë politikë dhe diplomaci.

Ndoshta dikush në pushtetin serb ka menduar se autoritetet perëndimore do të shqetësohen dhe nuk do të flenë të qetë pas zemërimit të Vuçiqit, por kjo dëshmon se diplomacia serbe është në një krizë shumë më të thellë sesa që mendohet. A mund të ketë me mjete të këtilla një zgjidhje më të mirë për Serbinë në çështjen e Kosovës?

Naim Leo Beshiri thotë se "me këtë sjellje infantile nuk mund të arrihet asgjë. E gjitha kjo është vetëm për përdorim të brendshëm, me qëllim që mbështetësit e Vuçiqit të mund të thonë se Vuçiqi ka mundësi që të zemërohet me dikë dhe të mos flas me ta. Asgjë pozitive nuk mund të ketë nga refuzimi i bisedimeve, sepse pa bisedime me Brukselin dhe qendrat e tjera ndërkombëtare, çështja me siguri nuk do të zgjidhet. Kjo do të thotë se bisedimet duhet të vazhdojnë, madje edhe me ata me të cilët nuk pajtohesh, e nëse bisedimet vazhdojnë, shtohet edhe mundësia e gjetjes së një kompromisi", konstaton Beshiri.

"KOSOVA PO KTHEHET NË KËSHILLIN E SIGURIMIT TË OKB-SË"

Çështja e Kosovës ngadalë po kthehet në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Kështu ka deklaruar ministri për Inovacion e zhvillim teknologjik i Serbisë Nenad Popoviq. Ai ka vlerësuar se bisedimet për Kosovën me ndërmjetësim të Bashkimit Evropian nuk kanë dhënë kurrfarë rezultati. "Është e qartë se pa SHBA-në, Rusinë e Kinën nuk është e mundur të arrihet kompromis i qëndrueshëm dhe i zbatueshëm ndërmjet Beogradit e Prishtinës. Çështja e Kosovës ngadalë po kthehet në vendin ku mund të zgjidhet, e ai është Këshilli i Sigurimit i OKB-së, ku Serbia i ka miqtë, Rusinë e Kinën, që e mbrojnë tërësinë

territoriale të Serbisë duke respektuar Kushtetutën tonë dhe Rezolutën 1244", ka thënë Popoviq. Ai në intervistë për "veçernje novosti" ka theksuar se është e qartë se shqiptarët nuk po duan ta formojnë Asociacionin e Komunave serbe dhe se për këtë e kanë përkrahjen e heshtur të disa vendeve perëndimore. "Nga ne pritët të ulemi në tavolinën ku na kanë mashtruar dhe me ata që e kanë përkrahur mashtrimin. Në kushte të tilla nuk duhet vazhduar bisedimet", ka thënë ai. Sipas fjalëve të tij, para syve të BE-së po realizohet plani i Shqipërisë së madhe e cila, ka thënë ai, do të sjellë destabilitet në tërë rajonin.

PLANI B I MAY DHE LËKUNDJA E MERKELIT

Në Britaninë e Madhe po mendohet për planet rezervë, në rast dështimi të negociatave për Brexitin. Ndërsa në Berlin janë intensifikuar mosmarrëveshjet dhe është dobësuar pozita e kancelares



Si pasojë e rezistencës në Bashkimin Evropian dhe planeve për Brexit, kryeministrja britanike Theresa May duket se po mendon edhe mundësinë e zgjedhjeve të parakohshme në Britani të Madhe. May u ka dhënë për detyrë këshilltarëve të saj politikë që në rastin më urgjent të mbahen zgjedhje të parakohshme në nëntor të këtij viti, njofton gazeta "Sunday Times". Kështu ajo synon të rifitojë mbështetjen e popullit për punën e saj si kryetare e qeverisë. Në Londër ka pasur edhe kërkesa për një referendum të ri për Brexitin, ku populli britanik edhe një herë do të thoshte mendimin e tij për këtë vendim. Negociatat e Brexitit janë futur në qorrsoak dhe aktualisht nuk dihet se si do të përfundojnë.

Komisioneri i BE, Günther Oettinger ka kërkuar nga partitë në koalicionin në Berlin që t'u japin

fund mosmarrëveshjeve të shumta, sepse imazhi i këtyre partive dhe i vendit po bie nga dita në ditë. "Do të jetë gjithnjë e më e vështirë që t'u shpjegojmë partnerëve tanë në Bruksel se pse në koalicionin e madh në Berlin po shpërthejnë kriza të rregullta dhe konflikte të reja, të cilat në fakt kanë një peshë shumë të vogël", tha Oettinger, duke folur për rastin e ish-shefit të

Zyrës federale për Mbrojtjen Kushtetuese, Maaben, i cili është larguar nga ky post dhe më pas është emëruar në postin e sekretarit të shtetit në Ministrinë e Brendshme. Por më pas liderja e Partisë Socialdemokrate, Andrea Nahles ka kërkuar rishikimin e këtij vendimi, për shkak të pakënaqësisë së madhe në bazë. Pritet që me këto mosmarrëveshje të merren sërish

krerët e tri partive në koalicion. Por fakt është që mosmarrëveshjet e fundit kanë dobësuar pozitën e Gjermanisë në Bruksel, sepse pozita e kancelares Merkel rrallë herë është lëkundur kaq shumë. Kjo gjendje natyrisht që influencon edhe bisedimet e Brexitit, të cilat duhet të përfundojnë deri në pranverën e vitit të ardhshëm.

"EVROPA TË PËRGATITET NË MARRËDHËNIET TRANSATLANTIKE"

Ministri i Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Heiko Maas tha se Evropa duhet të përgatitet për ndryshimet strukturore në marrëdhëniet transatlantike. Maas në një deklaratë për Agjencinë Gjermane të Lajmeve DPA tha se për disa vendime të SHBA-ve njoftohen nga rrjeti social Twitter. Ai shtoi se ka një përshtypje se edhe një pjesë e madhe e opinionit në SHBA vendimet e Shtëpisë së



Bardhë i mësojnë nga Twitter-i. Maas i cili sot do të udhëtojë në New York për të marrë pjesë në Asambleenë e Përgjithshme të OKB-së, rikujtoi se në të kaluarën për të gjitha çështjet e rëndësishme bëheshin konsultime intensive me SHBA-të, por që tanimë këto konsultime janë zvogëluar. Sipas tij, qeveria gjermane dëshiron që përsëri të ketë më shumë koordinim dhe dialog me SHBA-të.



Një tjetër akuzë seksuale për gjykatësin e Trumpit

Vetëm disa orë pasi, Christine Blasey Ford, kishte pranuar të dëshmojë para Komitetit të Senatit rreth akuzave që ka bërë kundër Brett Kavanaugh, të nominuarit të presidentit amerikan, Donald Trump për Gjykatën Supreme, një tjetër grua ka nisur akuza shtesë kundër gjykatësit. Më 23 shtator, avokatët e Ford kanë thënë se ajo është pajtuar të dëshmojë para Komitetit Gjyqësor të Senatit më 27 shtator. Ford, 51 vjeçare, ka akuzuar Kavanaugh për sjellje të keqe seksuale kur ajo ka qenë 15 vjeçare dhe gjykatësi 17 vjeçar.

Kavanaugh në anën tjetër i kundërshton të gjitha akuzat. Këto akuza kanë kthyer në situatë tensionuese procesin e emërimit të Kavanaugh si gjykatës në Gjykatën Supreme, pasi Komiteti Gjyqësor i Senatit ka shtyrë votimin për nominimin e tij, pas akuzave të Fordit një javë më parë. Ndërkohë më 23 shtator, mediat amerikane kanë raportuar se një tjetër grua ka akuzuar Kavanaugh për sjellje të keqe seksuale. Në raportimet filletare, The New Yorker ka thënë se Deborah Ramirez, 53 vjeçare, ka akuzuar gjykatësin për sjellje të keqe gjatë një feste në Universitetin Yale në vitet 1980. Disa demokratë kanë kërkuar që të shtyhet seanca e planifikuar për 27 mars, derisa supozimet e reja të hetohen.



Ambasadorja amerikane në Kombet e Bashkuara, Nikki Haley, i ka bërë thirrje Iranit "të

shikojë në pasqyrë", për shkaqet e sulmit në një paradë ushtarake, që ka lënë të vdekur 25 persona

Irani të shikojë veten në pasqyrë

të shtunën.

Haley ka thënë se presidenti iranian, Hassan Rohani "ka shtypur njerëzit e tij për një kohë të gjatë". Ajo është përgjigjur ndaj kritikave të ashpra të Rohanit kundër SHBA-së, të cilën e ka akuzuar për mundësim të kryerjes së sulmit. Dy grupe të ndara kanë pretenduar të kenë realizuar të shtënat, mirëpo asnjëri prej tyre nuk ka ofruar të dhëna.

Katër persona kanë shtënë me armë zjarri ndaj trupave të Gardës Revolucionare në qytetin jug-

perëndimor Ahvaz, duke lënë të vdekur 25 persona, përfshirë ushtarë dhe civilë që kanë ishin duke shikuar paradën. Një nga viktimat ka qenë një vajzë katërvjeçare. Grupi Arab, Rezistenca Kombëtare e Ahvazit dhe militantët e grupit ekstremist, Shteti Islamik kanë pretenduar se janë përgjegjës për vrasjet. Presidenti iranian ka akuzuar SHBA-në së bashku me shtetet e Gjirit Arab për kryerje të sulmit.

Mirëpo SHBA-ja ka kundërshtuar një gjë të tillë duke dënuar

"çdo sulm terrorist", derisa një zyrtar i lartë i Emirateve të Bashkuara Arabe, i ka cilësuar akuzat si "të pabaza". "Njerëzit në Iran janë duke protestuar, çdo shumë e parave që arrin në Iran, shkon për ushtrinë e tij, ai ka shtypur popullatën për një kohë të gjatë dhe duhet të shikojë drejt vetes për të kuptuar se prej nga vjen", ka thënë Haley për CNN. "Ai mund të na fajësojë neve. Mirëpo çfarë duhet të bëjë ai është të shikojë veten në pasqyrë", ka thënë ndër të tjerë ajo.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 189/2018

për punësimin e 17 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Komunën e Strumicës” për vendet e punës në vijim:

1. UPR 0101B03000 Ndhimës udhëheqës i sektorit për punë juridike dhe të përgjithshme	1 realizues(ë)	<ul style="list-style-type: none"> - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar 	<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar
<p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. 		<p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat 		<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 		<p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>4. UPR 0101B04000 Udhëheqës i njësive për kontroll buxhetore, Sektori për çështje financiare</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. 	<p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>7. UPR 0101V01000 Këshilltar për arsim fillor, Njësia për arsim, Sektori për arsim dhe veprimtari publike</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë - e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 31.331,00 denarë</p>		<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Arsim, Shkenca e letërsisë ose Psikologjisë - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion
<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 		<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>	<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
<p>2. INS 0101B03001 Ndhimës udhëheqës i Inspektoratit, Sektori për punë inspektoriale, Ndhimës kryeinspektori</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. 	1 realizues(ë)	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike ose Arkitekturë, Urbanizëm dhe Planifikim - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat 		<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 31.331,00 denarë</p>
<p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>		<p>5. UPR 0101B04000 Udhëheqës i njësive për punë komunale, Sektori për urbanizëm dhe punë komunale</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. 	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike ose Shkencat Ekonomike ose Arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim ose Ndërtimtari dhe Ekonomizim i Ujërave - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat 	1 realizues(ë)	<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara - udhëheqje; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>
<p>3. UPR 0101B04000 Udhëheqës i njësive për përkrahje administrative të Prefektit, Sektori për përkrahje të Prefektit</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. 	1 realizues(ë)	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 28.303,00 denarë</p>	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike ose Shkencat Ekonomike - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat 		<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik 	<p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>6. UPR 0101V01000 Këshilltar për punë normative-juridike, Njësia për punë juridike dhe të përgjithshme, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
<p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - punë me të tjerë/punë ekipore - ndërgjegjësimit strategjik 		<p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
		<p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI A sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike - së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion 	<p>Orari i punës :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ditët e punës e hënë-e premte - Orët javore të punës 40 - Orari ditor i punës 08:00 - 16:00 <p>Rroga neto: 25.023,00 denarë</p>
		<p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p>	<p>9. UPR 0101V01000 Këshilltar - analist urbanistik, Njësia për urbanizëm, Sektori për urbanizëm dhe punë komunale</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënime ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim ose Ndërtimtari dhe Ekonomizim të Ujërave
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.10. UPR 0101V01000 Këshilltar për punë juridike, 1 realizues(ë)
Njësia për urbanizëm, Sektori për urbanizëm dhe punë komunale**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat Juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.11. UPR 0101V01000 Këshilltar për punë juridike, 1 realizues(ë)
Njësia për menaxhim me tokë ndërtimore, Sektori për urbanizëm dhe punë komunale**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Shkencat Juridike
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.12. UPR 0101V01000 Këshilltar për mbrojtje të ajrit, 1 realizues(ë)
Njësia për mbrojtje të mjedisit jetësor, Sektori për zhvillim lokal ekonomik dhe mbrojtje të mjedisit jetësor**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Prodhimtari bimorë ose Mjedis jetësor
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.13. INS 0101V01001 Këshilltar - Inspektor për rrugë, 1 realizues(ë)
Njësia për punë inspektoriale në urbanizëm, punë komunale, mbrojtje të mjedisit jetësor, komunikacion rrugor dhe rrugët dhe rrugicat lokale - Inspektorat, Sektori për punë inspektoriale**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- nivevi i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Komunikacion dhe transport ose Ndërtimtari dhe Ekonomizim të Ujërave
- së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në komunikacion ose ndërtimtari

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 25.023,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

14. UPR 0101V02000 Bashkëpunëtor i lartë për menaxhim me rreziqe, Njësia për kontrollë buxhetore, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike, Shkencat Ekonomike ose Shkencat e Organizimit dhe udhëheqje (menaxhment)
- së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 21.996,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

15. UPR 0101V03000 Bashkëpunëtor për zbatimin e furnizimeve publike pa shpallje publike, Njësia për furnizime publike, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike ose Ekonomike
- së paku 1 (një) vit përvojë pune në profesion
- vërtetim për provim të dhënë për person me furnizime publike

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim

- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 21.239,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.16. UPR 0101V04000 Bashkëpunëtor më i ri - asistent 1 realizues(ë)
administrativ i Prefektit, Njësia për përkrahje administrative të Prefektit, Sektori për përkrahje të Prefektit**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkencat Juridike ose Ekonomike
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësime strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 19.725,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.17. UPR0101G01000 Referent i pavarur për punë 1 realizues(ë)
arkivore, Njësia për punë juridike dhe të përgjithshme, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme**Kushtet e përgjithshme:**

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm, gjimnaz ose shkollë të mesme profesionale (drejtimi i ekonomisë)
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë-e premtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 08:00 - 16:00

Rroga neto: 15.688,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.



Nga Qerim LITA

(vijon nga numri i kaluar)

Krerët e komitetit të porsaformuar ftuan edhe udhëheqjen e PKSH-së së Dibrës, që t'i bashkëngjiten të njëjtës, për një veprim të koordinuar, mirëpo e njëjta e refuzoi, duke deklaruar se: "...ka me veprue vetëm simbas instruksioneve që do t'i jepen prej qendrës së saj...". Në informatën plotësuese të policisë shqiptare, vihej në dukje, ashpërsimi i marrëdhënieve midis parisë nacionaliste dhe asaj komuniste:

"Qëllimi i Partisë Nacionaliste, - thuhej në informatë - asht të punojë në qetësi dhe të përgatitet që në një eventualitet zbarkimi të fuqive anglo-amerikane në Ballkan të fillojë veprimin e saj përkundër fuqive të Boshtit dhe deri në atë kohë, që ata shpresojnë të jetë e afërt, të përgatisi popullin moralisht dhe materialisht për luftimin...".

Dalja në skenë, e dy opsioneve politike: Bashkimi Dibran dhe Fronti Nacionalçlirimtar me në krye PKSH-në, e cila vepronte sipas diktatit të PKJ-së, ishte e qartë se shqiptarët në Maqedoninë Veriperëndimore të sotme, përfshi këtu edhe Dibrën e Madhe, masovikisht do të mbështesin opsionin e parë, sepse për ta nuk kishte alternativë tjetër përveç Bashkimit Kombëtar. Komiteti, siç edhe u emërtua, synonte bashkimin e mbarë drejtuesve shqiptarë në krahinën e Dibrës, pa marrë parasysh ideologjinë e tyre. Nisur nga kjo, drejtuesit e komitetit, mbajtën disa takime edhe me Aqif dhe Haxhi Lleshin, dhe për rrjedhojë më 2 gusht u formua Shtabi i përbashkët midis Komitetit "Bashkimi Dibran" dhe aradheve partizane që vepronin në Dibër. Shtabin e udhëhiqnin Fiqiri Dine dhe Hysni Dema si përfaqësues të nacionalistëve, ndërsa Esad Ndreu përfaqësonte komunistët. Duhet të vihet në dukje se ky shtab, qysh në fillim hasi në mosmarrëveshje, të cilat vinin nga shkaku se krahu nacionalist, kërkonte që forcat e bashkuara shqiptare të shpallnin zonë të lirë tërë krahinën e Dibrës, përfshi edhe Dibrën e Madhe dhe Peshkopinë, ndërsa Esat Ndreu, i cili përfaqësonte Frontin Nacionalçlirimtar, kërkonte që zonë e lirë të shpallej Peshkopia dhe krahinat përreth saj, pa e përfshirë Dibrën e Madhe. Mirëpo, pas insistimit të krahut nacionalist, edhe forcat partizane (që numerikisht në atë kohë ishin disa herë më të pakta se ato nacionaliste) u detyruan të marrin pjesë në çlirimin e Dibrës (8 shtator 1943).

Menjëherë pas çlirimit të qytetit të Dibrës, u vendos pushteti shqiptar, që përbëhej prej dy krahëve, atij nacionalist dhe komunist.

DIBRA E MADHE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (4)

VITI 1943, KUR DIBRA RA NË DUART E KOMUNISTËVE

Menjëherë pas çlirimit të qytetit të Dibrës, u vendos pushteti shqiptar, që përbëhej prej dy krahëve, atij nacionalist dhe komunist. Kjo politikë për komunistët jugosllavë ishte e papranueshme, prandaj Tempo me 1 tetor 1943 i dërgoi një letër Haxhi Lleshit, nga i cili kërkoi që të ndërmer masa të rrepta ndaj drejtuesve të Bashkimit Dibran, të cilët siç shprehet "janë bartësit e reaksionit shqiptaro-madh në Dibër"

Kjo politikë për komunistët jugosllavë ishte e papranueshme, prandaj Tempo me 1 tetor 1943 i dërgoi një letër Haxhi Lleshit, nga i cili kërkoi që të ndërmer masa të rrepta ndaj drejtuesve të Bashkimit Dibran, të cilët siç shprehet "janë bartësit e reaksionit shqiptaro-madh në Dibër", dhe se "ky reaksion reflektohet edhe në Kërçovë". Në vazhdim, Tempo i sugjeronte mikut të tij që mundësisht të shkaktoj "përçarje mes tyre, duke përfutur ndonjë prej tyre, gjithnjë duke pas parasysh që menjëherë të lëshohen propaganda për etiketimin e të tjerëve", si dhe të formoj një batalion të ri "me ushtarë të përzier shqiptaro-maqedonas", krejt kjo të bëhet "në frymën e vëllazërim-bashkimit, ku pushteti i ri i cili do të vendoset të jetë kryekëput pushtet komunist...". "Batalioni - shkruante më tej Tempo - të udhëhiqet prej maqedonasve dhe shqiptarëve vendas, si dhe të zbatohet me përpikëri, marrëveshjen e nënshkruar mes Shtabit të Përgjithshëm të LNÇSH-së dhe atij të LNÇM-së... sipas së cilës në ato territore duhet të vendoset pushteti jugosllav...".

Për rrjedhojë, H. Lleshi, së shpejti organizoi një takim të fshehtë me krerët e familjes Ndreu, përkatësisht me Cen Elezin, Xhetan e Beshir Ndreun, nga të cilët kërkoi ta braktisin Komitetin Bashkimi Dibran, për t'ju bashkuar forcave të FNÇSH-së. Njëkohësisht, Haxhi Lleshi, kërkoi nga Cen Elezi, që xhandarmëria të shkrihet në "Ushtrinë Nacionalçlirimtare", të nisen të gjitha forcat për luftë kundër parisë nacionaliste shqiptare, të bashkëpunojnë ngushtë me forcat e LNÇM-së, ndërsa zgjidhja e çështjes së kufijve ti lihet "Kartës së Atlantikut dhe Traktatit të Londrës". Takimi u mbyll pa ndonjë përfundim, me atë që ju mundësua Cen Elezit 24 orë kohë, që të këshillohet me shokët e Komitetit. Të nesërmit, Cen Elezi, e refuzoi ofertën, duke pohuar se do t'i tërheq forcat e veta, sepse nuk dëshiron të bëhet komunist dhe se: "nuk do të jetë shkaktar i vëllavrasjes". Për dallim nga Ceni, poli-

tikës vëllavrasëse të iniciuar nga Tempo, iu bashkuan disa krerë si: Faik Shehu, Hilmi Karahasani, Xhevdet Kumbaxhia, Ali Ndreu si dhe të gjithë Lleshit.

Në ato rrethana, krerët nacionalistë, për t'iu shmangur vëllavrasjes, i tërhoqën forcat e tyre nga Dibra e Madhe, me çka ky qytet ra në duart e pushtetarëve komunist maqedonas. Pushtimi i Dibrës nga aleanca komuniste jugosllavo-shqiptare, shkaktoi pakënaqësi tek shqiptarët e këtij qyteti, sepse pushteti nuk administrohej nga shqiptarët por nga jugosllavët. U mbyllën të gjitha shkollat shqipe dhe në vend të tyre u hapën shkollat maqedonase, në vend të flamurit shqiptar u vendos flamuri jugosllav me yllin e kuq pesërremësh që simbolizonte komunizmin. Ndërkohë, Tempo në një tubim të mbajtur në Kërçovë pohoi se: "së shpejti do të ngrihet flamuri Maqedhonas dhe në rast se do të kundërshtojnë reaksionarët atë do ta mbroj Ushtria Nacional Çlirimtare Shqiptare." Kjo deklaratë e Tempos, për Haxhi Lleshin ishte: "shumë me vend", mirëpo sipas tij: "reaksionarët gjetën rast për të ba propagandë kundra nesh si komunistë që bashkohemi me kombe tjera...". Tërë kjo situatë në Dibër të Madhe, zgjati deri më 16 nëntor 1943, kur forcat vullnetare të Komitetit Bashkimi Dibran, triumfalisht u futën në këtë qytet, duke i dëbuar partizanët në drejtim të Karaormanit, me çka Dibra e Madhe sërish u shndërrua në qendër kryesore politike, arsimore, kulturore, ekonomike e ushtarake të tokave lindore shqiptare.

Dëbimi i njëjësive pushtuese komuniste jugosllave nga tokat e liuara shqiptare, përkatësisht nga Dibra e Madhe dhe Kërçova, krijoi një stabilitet të përkohshëm. Autoritetet shqiptare të Prefekturës së Dibrës, për t'iu shmangur rrezikut të serishëm, kërkuan nga Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, të themeloj njësi të rregullta ushtarake. Rrjedhimisht, më 28 nëntor 1943, në Tetovë u themelua njësi e parë e rregullt ushtarake, Batalion Lu-

boten, i cili komandohej nga Gajur bej Derralla, ndërsa në shtabin komandues ishin edhe disa figura të shquara ushtarake të Dibrës: kapiten Burhan Kodra, agjutant, kapiten Qemal Mejdani, itendent batalioni, kapiten Vehap Daci, nëntoger Hilmi Leka etj. Përveç batalionit të më sipërm, në këto troje u themeluan edhe njësi ushtarake vullnetare shqiptare, që njiheshin si "Forca kreshnike". Komandat i përgjithshëm i këtyre forcave ishte ushtaraku dhe atdhetari i shquar shqiptar Xhemë Gostivari, ndërsa zëvendës të tij ishin: Mefail Zajazi, Arif Dragomanci, Uke Cami, Faik Dobovjani dhe Aqif Reçani.

Në ndër kohë, në këtë pjesë shqiptare, me insistimin e të deleguarit të KQ të PKJ-së, Svetozar Vukmanoviq - Tempo, u formua Komiteti Krahinor i Partisë Komuniste të Maqedonisë (PKM-së) për Pollog, Dibër, Rekë e Kërçovë. Në kuadër të këtij komiteti ishin përfshi edhe disa komunist shqiptar, si vëllazërit Agolli, Hamdi Dema etj. Përveç komitetit krahinor u formuan edhe disa aradha partizane maqedonase, të cilat bashkëvepronin me aradhen partizane të Haxhi Lleshit. Në janar të vitit 1944, Komiteti Krahinor i PKM-së për Pollog, Dibër, Rekë e Kërçovë, lëshoi një Thirrje në gjuhën shqipe, përmes së cilës ftohej shqiptarët për t'iu bashkangjitur "Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë" kundër okupatorit gjerman, ndërsa për çështjen e kufirit do të vendosej më vonë, nga vetë popullsia e atyre krahinave:

"...A asht Tetova e maqedonasve ose e shqiptarve, e kujt asht Kërçova..., atë do ta zgjidhni Ju vehtë mbas lufte, kurrë s'do të jetë okupatori gjakatar dhe kurrë lirisht do të mundeni t'i shprehni dëshirat e veta dhe të kërkoni të drejtat e veta...".

Një afishe me përmbajtje të ngjashme, ky komitet lëshoi edhe gjatë muajit shkurt 1944, përmes së cilës ftohej rinia shqiptare e Dibrës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe e Strugës që të organizojnë "kudo komitete të Rinis antifashiste vllaznore Shqiptaro-Maqedonase".

"Tradhtarët e popujve - thuhej në afishe, të cilët edhe deri më sot e shihen popullin, Mynyr Tërshana, Shaban Saliu, Osman Azizi, Shuaip Kamberi, Fiqiri Dine, Ali Maliqi...mobilizojnë rininë Shqiptare gjoja për mbrojtjen e Shqipnis. Bajnë gjindarmëri dhe polici fashiste, për ta mbledh rininë që të mund ta turbullojnë me propagandën e tyne helmuese dhe ta vënë në shërbim të interesave të veta...". Afishja përfundonte me parullat e njohura komuniste: "Rrënoftë Ushtria Nac. Çlirimtare Maqedone e Shqiptare! Rrënofshin repartet Partizane Shqiptaro-Maqedone Nacionalçlirimtare, hakmarrësit e sotshëm të popullit! Rrënoftë Ushtria e Kuqe fitimtare dhe prisi, mësuesi i saj marshall i URSS-it J. V. STALIN!...etj".

Rrjedhat e më vonshme dëshmuar të kundërtën nga ajo që thuhej në dy dokumentet e cituara më lartë, përkatësisht, se të njëjtat, nuk patën asnjë qëllim tjetër, përveçse mashtrimin e popullit shqiptar në krahinën e Dibrës së tërësi, i cili asaj kohe qëndronte fuqishëm në linjën e politikës së "Bashkimit Dibran", e cila politikë ishte në frymën e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare, e themeluar në Gjakovë, me ndërmjetësimin e Misionit Anglez, në mbarim të vitit 1943. Në këtë linjë, krahas Kryezinjëve, qëndronin edhe figurat e shquara të Lumës e të Dibrës siç ishin: Muharem Bajraktari, Zenel Lita, Dostan Rexhepi, Cen Elezi, Fiqiri Dine, Uke Cami, Shemsi Hatipi, Osman Cami, Qeram Zllatku, Medat Tërshana, Fik e Ali Maliqi etj. Kjo provohet nga letrat e shumta të krerëve politik e ushtarak jugosllav, që me këtë rast po i referohemi letrës së anëtarit të Sh.K. të LNÇM-së, Cvetko Uzunovski -Abas, dërguar më 18 maj 1944, ShK të LNÇSH-së, përmes së cilës kërkohet vendosja e brigadave komuniste shqiptare në territorin e Dibrës, Tetovës, Gostivarit, Kërçovës dhe Strugës:

"Thyemja e reaksionit - thuhej në letër - në Shqipninë e Mesme dhe në terrenin e Dibrës, Kërçovës, Strugës, Tetovës dhe Gostivarit, do të thotë me e izolu okupatorin gjerman dhe me e sulmue kur të dësh dhe si të dësh. Kjo do të thotë edhe më tutje: të krijosh kondita për me shvillue luftën në Shqipninë e Veriut dhe në Kosovë, dhe lidhjen e Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Shqipnisë me Ushtrinë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë...".

(vijon në numrin e ardhshëm)

PILOTI SHQIPTAR S'KA TË NDALUR

LIRIMI VENDOS REKORD NË FORMULA 4

"Ky ishte një fund i përsosur, duke e mbyllur sezonin me dhjetë fitore. Fitova gjysmën e garave, por doja që këtë fundjavë të merrja një fitore të trefishtë, që për fat të keq nuk e arrita. Gjithsesi me dy fitore jam i kënaqur sepse kam bërë më të mirën që skuadra të fitojë kampionatin", u shpreh Lirim Zendeli



E ka përfunduar në mënyrë të shkëlqyer sezonin në Formula 4, djaloshti shqiptar nga Maqedonia, Lirim Zendeli. 18-vjeçari është tashmë zyrtarisht kampion i Formula 4, teksa në garën e fundit atë të Hockenheimring në Gjermani, Zendeli arriti të fitojë garën, duke e mbyllur sezonin kështu me një rekord. Ndonëse ishte shpallur kampion gjashtë javë para përfundimit të kampionatit, të dielën pasdite talenti shqiptar i Formula 4, arriti të korr një tjetër sukses, duke fituar 10 nga 20 garat e këtij kampionati. Ky është një rekord për pilotin shqiptar por edhe për ekipin e tij, US Racing - CHRS që drej-

tohet nga Ralf Schumacher, vëllai i Michael Schumacher gjithashtu ish-pilot i Formula 1. Në garën e ditës së diel, Lirim Zendeli e nisi garën nga vendi i tetë, por në fund arriti të kalonte të gjithë kundërshtarët duke rrëmbyer vendin e parë. Pas përfundimit të garës, Lirim Zendeli është shprehur i lumtur për fundin e sezonit dhe sukse-

sin personal por dhe ekipor të arritur në garat e Formula 4. "Ky ishte një fund i përsosur, duke e mbyllur sezonin me dhjetë fitore. Fitova gjysmën e garave, por doja që këtë fundjavë të merrja një fitore të trefishtë, që për fat të keq nuk e arrita. Gjithsesi me dy fitore jam i kënaqur, sepse kam bërë më të mirën që skuadra të fitojë kampio-

natin", u shpreh Lirim Zendeli. Trajneri i tij, ish-piloti i F1, Ralf Schumacher, është shprehur me superlativa për Zendelin, duke vlerësuar talentin e tij dhe punën e bërë gjatë sezonit. "Ky ishte një sezon i madh dhe jemi shumë të mënqur"-tha Ralf Schumacher pas garave. "Sezoni ka qenë fryt i punës sonë, kemi qenë të fortë në tre sezonet e fundit, por të fitosh tre tituj në një sezon, kjo është qershia mbi tortë. Lirimi na ka dhënë shumë sukses, ai është në vitin e tij të tretë, ka bërë një punë të shkëlqyer. Në situata të vështira nuk ka bërë gabim. Është punë shumë e mirë pas kalimit nga garat kart në Formula 4. Atje ishte kulmi i mësimi pasi garoi gjithmonë me shoferët më të fortë", është shprehur Ralf Schumacher. Skuadra e US Racing-CHRS u shpall kampione e trefishtë e këtij kampionati, pasi veç Lirim Zendelit që fitoi renditjen e përgjithshme si pilot, skuadra fitoi titullin e Konstruktorëve ndër- sa David Schumacher u shpall si piloti më i mirë debutues, edhe ky pjesë e ekipit të US Racing.



Osmani: Fitore me vlerë në terren të vështirë

Shkup, 24 shtator - Triumfi 2:1 në fushë të Sileksit në kuadër të xhiros së gjashtë në LPFM me gol të shënuar në kohën shtesë vlerësohet me nota pozitive nga trajneri Osmani që sërish potencion se skuadra mundet edhe më mirë. Gjithsesi sipas teknikut kuqezi futbollistët nuk mundën të zhvillojnë lojën e dëshiruar në një terren jo aq ideal, ndërsa vendimtar ishte klasi i Ibraimit në çastet e fundit të takimit. "Edhe pse nuk e luajtëm lojën tonë më të mirë, me rëndësi është që morrëm tre pikët. Kemi përmendur shpesh karakterin e skuadrës dhe sot ekipi dëshmoi edhe një herë pasi kur me 10-të lojtarë pranuan gol më pas reaguam duke shënuar golin e fitores. E përsëris se nuk ishim në nivelin tonë dhe arsyeja mbase është te gjendja e terrenit që nuk lejonte të zhvillojmë lojën që duam, rrjedhshëm si në ndeshjet e kaluara", deklaroi trajneri Qatip Osmani.

PORTIERI I VARDARIT SHPËRTHEN NDAJ VISAR MULLIUT

Gaçevski: Nuk më besohet se lojtar si ti i mbron ngjyrat e Maqedonisë

Shkup 24, shtator - Me fitoren ndaj Rabotniçkit ekipi i Vardarit ka arritur të ruan pozitën e tretë në tabelë në futbollin vendor, ndërsa kjo fitore e Vardarit ishte shkak që portieri Gaçevski të përgjigjet në provokimet të cilat për ekipin shkupjan i dërgoi ish futbollisti i tyre, ndërsa tani pjesë e Shkëndijës, Visar Musliu. "Gjatë sezonit të kaluar pjesa e dytë e kampionatit ishte më i lehtë, për arsye se Vardari kishte probleme të brendshme në klub. Këtë vit mendoj se do të jetë edhe më lehtë se sezonin e kaluar, përshkak se nuk kemi konkurrence serioze me Vardarin. Ata këtë sezon janë shumë

më të dobët nga viti i kaluar", patë deklaruar Visar Musliu në fillim të sezonin të ri futbollistik. Mirëpo këtyre fjalëve të cilat i ka marrë si provokim portieri i Vardarit ka reaguar në profilin e tij në Facebook. "E more Visar Musliu, je shumë qesharak! Nuk më besohet se lojtar sikur ti i mbron ngjyrat e përfaqësueses së Maqedonisë. Dua që të përshëndes nga tifozët e mi dhe kolegë. Shkëndija duhet edhe shumë të han që të behët Vardar. Vardari është i shenjtë, Vardari edhe krenaria e Maqedonisë", ka shkruar në profilin e tij Facebook, portieri i Vardarit, Filip Gaçevski.



Shkup, 24 shtator - Skuadra e FC Shkupi ka shënuar fitoren e parë në sezonin vjeshtor të kampionatit të ri futbollistik, duke e mundur ekipin e Makedonija Gj.P., me re-

Soydas: E thyem akullin, presim ngritje në tabelë

zultat 2:1, me autor të golave Viktor Angellov dhe Blazhe Ilijoski. Për duelin e djeshëm është prononcuar trajneri Hayati Soydas, i cili ka thënë se është thyer akulli dhe se pret tani edhe më shumë nga ekipi, që të jetë në pozitë më të lartë në tabelë. "Ndeshja e djeshme ishte shumë e rëndësishme për ne, e dini se si ishte situata në klub, kishim disa humbje radhazi dhe jemi të kënaqur që arritëm të fitojmë. Duke e parë tabelën, Makedonija Gj.P., ishte konkurrenti ynë i drejtpërdrejtë në tabelë dhe kjo e bëri edhe më të rëndësishme këtë ndeshje për ne. Ne para përballjes, biseduam me futbollistët dhe ata

e dinin se situata është tejte e vështirë pas rezultateve të dobëta, këtë e shfrytëzuan ata dhe arritëm të fitojmë. Para ndeshjes u morëm vesh që në fushë të luftojmë deri në minutat e fundit dhe të luajmë më të koncentruar dhe arritëm të bëjmë lojën që e kishim planifikuar më parë. Jam shumë i kënaqur se si eci ndeshja, kishim raste të mira për të shënuar, thjesht luajtëm mirë. Mendoj se mundeshim edhe më herët ta mbarojmë ndeshjen, që të shënojmë golin e dytë, por nuk ndodhi ajo. Edhe pse pranuan gol dhe rezultati u barazua, futbollistët e tanë treguan karakter dhe rritën tempon e nde-

shjes dhe arritëm që përmes penaltisë të fitojmë ndeshjen. Dua të potencoj një gjë shumë të rëndësishme, që është pozitive për klubin, shkak që në ekipin tonë kishim tre futbollist të ri nga 17-18 vjeçar. Tani më e dimë se Suhejl Muharemi është pjesë e ekipit si startues, në dy ndeshjet e fundit e kemi edhe Besir Ramadanin, ndërsa dje fitoi shansin edhe Jusuf Aliu, i cili ka vetëm një javë që po stërvitet me ekipin, ndërsa dje debutoi me seniorët. Kjo do të thotë se ky ekip ka kualitet dhe kjo ishte një ndeshje ku do të thoja se e thyem akullin, e arritëm fitoren e parë dhe shpresojmë që të vazhdojmë

kështu. Shpresojmë që në të ardhmen do ta gjejmë veten sa më lartë në tabelën e klasifikimit. Ishte kjo një ndeshje që besoj se e kemi ngritur besimin në vete, po e them edhe një herë se ishte shumë ndeshje e rëndësishme dhe shpresoj të vazhdojmë kështu", ka përfunduar trajneri Soydas. Të përkujtojmë se në ndeshjen e djeshme Shkupi përveç mungesës së Besart Kri-vanjevës, kishte jashtë ekipit edhe Rron Brojën i cili ka marrë një lëndim në nyjën e këmbës, që me shumë gjasa do ta lërë futbollistin jashtë ekipit edhe për duelin ndaj Bellasicës, që luhet të mërkurën në Strumicë.

Në bazë të nenit 89-a paragrafi 1 alineja 5 e Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 78/03, 67/04, 51/05 US, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/17 dhe 64/18), nenit 97 dhe 98 të Statutit të SHMQSH "Koço Racin", Vendimit të Kryetarit të Qytetit të Shkupit për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit numër 08-7818/1 të datës 07.09.2018 dhe Vendimit të Këshillit të shkollës numër 02-381/3 të datës 20.09.2018, Këshilli i shkollës së SHMQSH "Koço Racin",
Publikon

SHPLLJE PUBLIKE
për zgjedhje të drejtorit të shkollës

Kandidatët për Drejtor të shkollës, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet të përmbushen edhe kushtet në vijim:

- Të kenë të mbaruar arsimin sipëror
- Të përmbushin kushtet për mësimdhënës, pedagog ose psikolog në shkollë të mesme
- Të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Në momentin e zgjedhjes, me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje, ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës
- Të kenë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës
- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë
- të kenë të dhënë provimin për drejtor të shkollës
 - të mos jenë të dënuar kusht i paraparë në nenin 43, paragrafi (2) i Ligjit për institucionet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/05, 12/05 dhe 50/11).
 - Të kenë certifikatë përkatese, jo më të vjetër se pesë vjet, për njohje të gjuhës angleze (TOEFL IBT) – së paku 30 pikë, (IELTS) – së paku 3 pikë, (BULATS) – së paku 20 pikë ose (KET) (Cambridge English) – të dhënë ose APTIS së paku B2.
- Kandidatët për Drejtor të Shkollës duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje në lidhje me shpalljen publike me biografi të shkurtër (CV) dhe letër motivimi.
 - Program për punë të drejtorit të shkollës prej vitit 2018 deri në vitin 2022.
 - Diplomë/Certifikatë për arsim të mbaruar sipëror
 - Dëshmi se kundër kandidatit nuk është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës të dhënë nga organi kompetent (dëshmia të cilën do ta parashtrorë kandidati do të jepet nga organi kompetent në periudhë kohore derisa të zgjasë shpallja publike)
 - Vërtetim për përvojën e punës në punë edukativo-arsimore, të dhënë nga institucionet e verifikuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kryerje të punës edukativo-arsimore.
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë.
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës.
 - Dëshmi për posedim të certifikatës jo më të vjetër se 5 vjet për njohje të gjuhës angleze (TOEFL IBT) – së paku 30 pikë, (IELTS) – së paku 3 pikë, (BULATS) – së paku 20 pikë ose (KET) (Cambridge English) – të dhënë ose APTIS së paku B2.
 - Dëshmi se kundër kandidatit nuk ka aktakuzë që është futur në fuqi ligjore të dhënë nga Gjykata themelore në vendin e lindjes së kandidatit, në pajtim me nenin 43 paragrafi 2 të Ligjit për institucionet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 32/05, 12/05 dhe 51/11) (dëshmia të jetë jo më r vjetër se 6 – gjashtë muaj).
 - Dëshmi se kandidatët për drejtor kanë gjendje të përgjithshme shëndetësore (certifikatë të mjekut) pas zgjedhjes do ta parashtrorë vetëm kandidati i zgjedhur, i cili do të dërgohet në kontroll mjekësor në llogari të punëdhënësit, në pajtim me nenin 25, paragrafi (7) i Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16).

Afati për parashtrimin e dokumenteve të përcaktuara në nenin 98 nga Statuti i SHMQSH "Koço Racin" Shkup zgjatë 8 (tetë) ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e publikimit.

Me kandidatët të cilët i përmbushin kushtet do të realizohet intervistë për çka do të informohen të njëjtit enkas.

Vendi i punës drejtor i shkollës është vend pune me autorizime të posaçme. Mandati i drejtorit të zgjedhur do të jetë (4) vjet, duke konsideruar nga dita e emërimit.

Pagesa bazë parashihet në pajtim me matjet dhe kriteret e përcaktuar me Marrëveshjen kolektive për arsim të mesëm me koeficient të komplikimit 3.422 dhe neto shumë prej 28.814,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0,5% për çdo vit të stazhit të punës, të përcaktuar në (5) ditë pune me dyzet (40) orë pune në javë me orar ditor të punës prej ora 08:30 deri në ora 16:30.

Zgjedhja do të realizohet në afatet e parapara në pajtim me Nenin 92-a të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta Zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 78/03, 67/04, 51/05 US, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/17 dhe 64/18), ndërsa më së voni në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditë.

Dokumentet e nevojshme në zarf të mbyllur në original ose kopje të vërtetuar në noter, të dorëzohen në SHMQSH "Koço Racin" – Shkup, rr. Lihnidra" nr. 3, 1000 Shkup me shenjë deri tek Këshilli i shkollës – Komisioni për shqyrtim të dokumenteve në lidhje me shpalljen publike për zgjedhje të drejtorit të shkollës përmes postës ose postës së shpejtë ose në arkivin e shkollës.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruar pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

Kontakt personi në lidhje me shpalljen publike është Sekretari i shkollës – Daniel Radicevski me kontakt telefon 02/2037073 dhe kontakt e-mail adresë dsu_kocoracin@yahoo.com

Këshilli i shkollës së SHMQSH "Koço Racin"
KRYETAR
Robert Nestorovski

KONKURS
për përmbledhje poetike

Shtëpia e Kulturës "Koço Racin" – Shkup shpall konkurs për përmbledhje poetike me rastin e "Ditës së Alfabetit të Gjuhës Shqipe".

Kushtet paraprake:

- përmbledhja poetike duhet të përmbajë më së shumti 1200 vargje
- të shkruhet në gjuhën amtare
- të jetë e pabotuar deri më tani
- të drejtë pjesëmarrje kanë të gjithë autorët e rinj deri në moshën 35 vjeçare.

Shkrimet duhet të dërgohen në 3 kopje me shifër (në zarf të veçantë të shkruar: emrin, mbiemrin dhe numrin amë të autorit si dhe tel për kontakt) në adresën: "Dimitrie Ćupovski" 20a, fax:173 (me shenjë- Për konkursin e përmbledhjes poetike), 1000 Shkup, më së voni deri më 25 tetor 2018.

Juria profesionale do të ndaj çmim për vendin e parë-shpërbllim në të holla, botim si dhe promovim të përmbledhjes poetike në institucionin tonë.

Tel. Kontakt: 02/3163-739 Mob: 078 232 806

Në bazë të nenit 17, nenit 18 dhe nenit 19 të Rregullores për mënyrën dhe realizimin e ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira për nxënësit nga shkollat fillore, si dhe Programit vjetor për punë të SHFK "Jan Amos Komenski" Shkup, rr. "Varshavska" nr. 23, tel. 02/306 46 45, në vijim publikon këtë:

SHPLLJE
Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve shkollore dhe aktivitetet tjera të lira për nxënës për vitin shkollor 2018/2019

Furnizues:
SHFK "Jan Amos Komenski" Shkup, me seli në rr. "Varshavska" nr. 23, 1000 Shkup, tel. 02/306 46 45

Ofertues:
Subjektet e vendit juridike

Lënda e furnizimit:

1. Ekskursion mësimor-shkencor një ditor për nxënës të klasës së III – relacioni Shkup, Kriva Pallankë, Shkup. Manastiri "Sv. Joakim Osovoski" – Kriva Pallankë
2. Ekskursion dyditor mësimor-shkencor për klasën e VI Lokacionet për bujtje: Krushevë, Manastir;
3. Ekskursion treditor mësimor-shkencor për klasën e IX Lokacioni për bujtje: Strumicë, Dojran
4. Mësim në natyrë për klasën e V (5 ditë) Lokacioni për bujtje: Dojran
5. Pushim dimëror për nxënësit prej klasës së VI deri në IX Lokacioni: Qendra turistike – Krushevë, Mavrovë, Ponikva
6. Verime për nxënësit prej klasës së VI deri në IX Lokacioni: Ohër

Kriteret për ofertesuesin:

Kriteri për ndarje të marrëveshjes për realizimin e ekskursioneve dhe aktivitetet tjera të lira është çmimi më i ulët.

Kushtet minimale që duhet të përmbushë ofertesuesi:

- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për realizimin e veprimtarisë përkatese turistike (Vendim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë)
- Të ketë së paku tre vërtetime për realizim të suksesshëm të së paku 3 ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira në 3 vitet e fundit, të nënshkruara dhe vërtetuar nga subjektet për të cilat është realizuar shërbimi.
- Të plotësojë kushtet për udhëtim të grupeve të fëmijëve në pajtim me ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve.

Oferta në pajtim me lëndën për furnizim duhet të përmbajë:

- emrin e subjektit juridik, nënshkrim të personit përgjegjës dhe vulë;
- çmim individual dhe të përgjithshëm të shërbimeve për fëmijë (vendosje, transport dhe ushqim) me TVSH të përfshirë;
- kushtet për vendosje, meny për ushqim dhe transport;
- çmimi të përfshijë edhe sigurim të posaçëm të nxënësve;
- mënyra e pagesës;
- mjek;
- dëshmi për së paku 6 (gjashtë) të punësuar me licencë për përcjellës të grupeve
- kushte të vulltshme për nxënësit të cilët vijnë nga familjet e prekura sociale
- të posedojë dëshmi për qira të objekteve në pajtim me kërkesat e theksuara;
- dëshmi për transport të siguruar në pajtim me kushtet e theksuara për transport;
- garanci bankare për realizim kualitativ të ekskursionit në shumë prej 5% të vlerës së marrëveshjes (dorëzohet ofertesuesi i zgjedhur në ditën e nënshkrimit të marrëveshjes)

Subjektet e interesuara juridike mund të marrin kërkesë dhe specifikacion teknik nga Arkivi i shkollës, ndërsa ti dorëzojnë ofertat e tyre deri në SHFK "Jan Amos Komenski" rr. "Varshavska" nr. 23, Shkup personalisht në zarf të mbyllur me shenjë – Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursione. Personi për kontakt: **Julijana Paskoska**

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit.

Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar pas afatit nuk do të merret parasysh.

SHFK "Jan Amos Komenski"
Rr. "Varshavska" nr. 23 Shkup

KOMUNA E KARPOSHIT
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51, paragrafi 10 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

LAJMËRIM

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të PN 1.2.1 dhe PN 1.2.2, me paraparcim të PN 1.2 me klasë themelore të qëllimit G3 – shërbime, nga PDU për pjesë të lokalitetit Momin Potok, Komuna e Karposhit.

Anketa publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të PN 1.2.1 dhe PN 1.2.2, me paraparcim të PN 1.2 me klasë themelore të qëllimit G3 – shërbime, nga PDU për pjesë të lokalitetit Momin Potok, Komuna e Karposhit, do të mbahet prej më 27.09.2018 deri më 03.10.2018, çdo ditë pune prej ora 07.30 deri më 15.30, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të PN 1.2.1 dhe PN 1.2.2, me paraparcim të PN 1.2 me klasë themelore të qëllimit G3 – shërbime, nga PDU për pjesë të lokalitetit Momin Potok, Komuna e Karposhit, do të mbahet më datë 01.10.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Kufiri i përfshirjes projektuese ndeshet me kufirin e PN 1.2 të PDU për pjesën e lokalitetit "Momin Potok", Komuna e Karposhit. Prej verit kufizohet me PN 1.1, prej jugut me PN 1.3, prej lindjes me brezin mbrojtës (gjelbërimi mbrojtës) në rrugën magjistrale Shkup-Kaçanik, ndërsa prej perëndimit me Rrugën e re të projektuar "1" përmes së cilës me komunikacion do të lidhet me rrjetin e mbetur rrugor.

Sipërfaqja e përfshirjes së hapësirës për të cilën ka të bëjë ky Projekt arkitektonik-urbanistik është P= 1496,82 m².

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizam

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shfaqja grafike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të PN 1.2.1 dhe PN 1.2.2, me paraparcim të PN 1.2 me klasë themelore të qëllimit G3 – shërbime, nga PDU për pjesë të lokalitetit Momin Potok, Komuna e Karposhit dhe informata më të hollësishme për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës së Karposhit - www.karposhit.gov.mk dhe në sistemin informativ E-urbanizam.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtrorë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizam, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS SË KAPOSHIT
Stefan Bogoev

KOMUNA E KARPOSHIT
KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 35 ndërsa në lidhje me nenin 51, paragrafi 10 i Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16), Kryetari i Komunës së Karposhit, në vijim sjellë

LAJMËRIM

Për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banesore në PK948/1, PK 918/1 dhe PK918/2, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit.

Anketa publike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banesore në PK948/1, PK 918/1 dhe PK918/2, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, do të mbahet prej më 27.09.2018 deri më 03.10.2018, çdo ditë pune prej ora 07.30 deri më 15.30, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Prezantimi publik për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banesore në PK948/1, PK 918/1 dhe PK918/2, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit, do të mbahet më datë 01.10.2018 në ora 13.00, në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9).

Përfshirja projektuese kapë PK918/2, pjesë nga PK 918/1 dhe pjesë nga PK948/1, KK Bardovcë.

Sipërfaqja e përfshirjes së hapësirës për të cilën ka të bëjë ky Projekt arkitektonik-urbanistik është P= 3066 m².

Listat anketuese për pjesëmarrje në Anketën publike do të gjenden në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në sistemin E-urbanizam

Lajmërimi për organizim të prezantimit publik dhe anketës publike, shfaqja grafike për Projektin arkitektonik-urbanistik për formim të parcelave ndërtimore me klasë themelore të qëllimit A1 – banim në shtëpi banesore në PK948/1, PK 918/1 dhe PK918/2, KK Bardovcë, Komuna e Karposhit dhe informata më të detajuara për të njëjtat do të publikohen në UEB faqen e Komunës së Karposhit - www.karposhit.gov.mk dhe në sistemin informativ E-urbanizam.

Në afatin e caktuar, subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mund të parashtrorë vërejtjet në listat anketuese në lokalet e Komunës së Karposhit (Baraka 2 – rr. Radika nr. 9) dhe në formë elektronike përmes sistemit informativ E-urbanizam, në pajtim me nenin 35 paragrafi 5 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16).

KRYETARI I KOMUNËS SË KAPOSHIT
Stefan Bogoev

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe 3 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr. 62/2005 dhe 113/2014), Drejtori i SHMKM "Nikolla Shtejn" Tetovë shpall:

KONKURS

Për plotësimin e një vendi të lirë
të punës për vitin 2018/2019

1) Mësimdhënës të Matematikës - Në gjuhën mësimore maqedonase

me fond të orëve të plotë, 22 orë mësimore, një vend të punës për afat të caktuar më së voni deri 31.12.2018, orari i punës prej 7.30 deri 12.00 tre ditë pune, dhe dy ditë pune nga ora 13.30 deri 18.00, pagesa mujore 21.500,00 denarë, të ketë të kryer FSHN- drejtimi Matematike - shkalla VII/1 .

Shpallja do zgjat pesë ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim të mesëm.

Dokumentet e nevojshme:

- Kërkesë
- Diploma (ose kopje e noterizuar)
- Certifikata e nënshtetësisë
- Certifikata e studimeve si dëshmi për shkallen e studimeve .

Dokumentet mund ti dorëzoni personalisht ose me post ne adresën SHMKM

"Nikolla Shtejn"- Tetovë Rr. Ilindenit pa numër –Tetovë.

Tetovë

24.09.2018

Drejtor,

Jehona Xheladini Zaiti

Koha <http://www.koha.mk>

Koha

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e hotuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev ur.11, I Q.T. Mavrovassja lok.14 - përdhësë, Shkup

Janë humbur dëftesat e vitit të parë dhe të dytë të SHM Arsenie Jovkov - Shkup të personit Parsim Jonuzi dhe njëkohësisht shpallen të pavlefshme.

G4, "TË FORTËT" E EUROPËS QË NJOHIN VETËM FITORE!

Në kuadër të kësaj analize, nga Franca, në Angli, Itali dhe vazhduar në Gjermani, katër skuadra kryesojnë renditjen dhe ende nuk kanë provuar shijen e një barazimi apo humbje. Po flasim për Paris SG, Liverpool, Juventus dhe Bayern Munich, me pikë të plota, edhe pse numri i ndeshjeve të zhvilluara ndryshon

Jemi vetëm në fillim të edicionit futbollistik dhe ku kampionatet "big" sapo kanë nisur rrugëtimin, por megjithatë kjo nuk na pengon që të nxjerrim edhe disa shënime të para mbi ecurinë e skuadrave. Në kuadër të kësaj analize, nga Franca, në Angli, Itali dhe vazhduar në Gjermani, katër skuadra kryesojnë renditjen dhe ende nuk kanë provuar shijen e një barazimi apo humbje. Po flasim për Paris SG, Liverpool, Juventus dhe Bayern Munich, me pikë të plota, edhe pse numri i ndeshjeve të zhvilluara ndryshon. Në fakt, në krye të kësaj mini tabele qëndron skuadra fran-

FRANCË	ANGLI	ITALI	GJERMANI
PSG - 6 NDESHJE 18 PIKË	LIVERPOOL - 6 NDESHJE 18 PIKË	JUVENTUS - 5 NDESHJE 15 PIKË	BAYERN - 4 NDESHJE 12 PIKË
20 GOLA TË SHËNUAR 5 GOLA TË PËSUAR	14 GOLA TË SHËNUAR 2 GOLA TË PËSUAR	11 GOLA TË SHËNUAR 4 GOLA TË PËSUAR	12 GOLA TË SHËNUAR 2 GOLA TË PËSUAR

ceze dhe ajo angleze, që kanë 18 pikë të plota pas 6 ndeshjesh dhe 6 fitoresh. Kampionët e Francës përmbysën Rennes në fundjavën e shkuar, duke vendosur edhe rekord historik me 3 suksese radhazi në transfertë. Janë 20 gola në total të shënuar dhe 5 të pësuar për parizienët. Pas tyre vjen Liverpool i Jurgen Klopp, që gjithashtu ka 18 pikë në 6 ndeshje, me 6 fitore ku kanë shënuar 14 gola dhe kanë pësuar vetëm 2 të tillë. Kryesuesit e Premier League duket se këtë sezon do të ndjekin realisht atë trofe që i

mungon prej 28 vjetësh. Menjëher pas tyre pozicionohet Juventus i Massimiliano Allegri, që në pesë ndeshje ka marrë po aq fitore dhe kryeson renditjen e Serisë A me 15 pikë të plota. Nën shenjën e Cristiano Ronaldos, skuadra bardhezi ka arritur që të dalë me pikë edhe nga një fushë që iu kthye tmerr, ajo e Frosinones. Portugezi është në kuotën e 3 golave. Skuadra bardhezi, që fiton prej 7 vitesh radhazi titullin, ka shënuar 11 gola dhe pësuar 4. Në fund, Bayern Munich, që megjithatë ende nuk ka arritur 5

ndeshje për të matur forcën. Katër fitore në katër javë dhe 12 pikë të plota për kampionët e Gjermanisë, që kanë realizuar në total 12 gola dhe pësuar vetëm 2, aq sa Liverpool. U largua nga kjo listë ekipesh perfekte Barcelona, pas barazimit 2-2 me Gironan në shtëpi. Një hap fals që nuk e mban të pastër tabelën e barazimeve në La Liga. G4, ose grupi "i të fortëve" po bën ligjin në Europë. Tani, të shohim se çfarë do të ndodhë në ndeshjet në vijim, por kandidatura e tyre për të arritur suksesin këtë sezon duket e qartë.



Fekir në radarin e Real Madridit

Duket se Chelsea dhe Liverpool nuk janë të vetmet ekipe që kanë qenë në ndjekje të Nabil Fekir gjatë verës së kaluar. Sipas "L'Equipe", Real Madrid ka ndjekur gjithashtu 25-vjeçarin, si një nga zëvendësuesit e mundshëm të Cristiano Ronaldo. Gjithsesi, Florentino Perez ende nuk ka bërë një ofertë zyrtare, diçka që mendon ta bëjë në të ardhmen. Në sezonin e kaluar mesfushori me tipare sulmuese shënoi 18 gola dhe dha 8 asiste në Ligue 1. Ai kreu vizita mjekësore te Liverpool gjatë verës, por marrëveshja nuk u arritur, sepse "të kuqtë" patën dyshime në lidhje me një dëmtim të pësuar tre vjet më parë. "Nuk më ka kërkuar vetëm Liverpool, e dini edhe për kontaktet me Chelsea por kam qenë në bisedime me një tjetër klub të madh, gjithsesi jam ende pjesë e Lyon dhe duhet të jap maksimumin në këtë sezon", tha Fakir, pas fitores ndaj Manchester City në Champions League. Vlera e tij në merkato është rreth 60 milionë euro.

Gattuso kërkon një Milan ndryshe në 30 minutat e fundit

Trajneri i Milanit, Gennaro Gattuso, ndjen keqardhje se skuadra e tij nuk arriti më shumë se një barazim 2-2 në San Siro kundër Atalantas. Trajneri italian e shikon problemin në 30 minutat e fundit, ku skuadra nuk po arrin të vazhdojë me lojën e mirë. "Ka shumë keqardhje, por nuk jam i nervozuar", ka thënë Gattuso për Sky Sport Italia. "Kjo është skuadër me dy fytyra. Kemi luajtur një pjesë të parë në mënyrë të mrekullueshme, por ishim në vështirësi në gjysmë orën e fundit. Ne nuk po arrijmë të kemi një paraqitje konstante për 90 minuta. Duhet të bëjmë më shumë, ka shumë ndeshje në këtë sezon dhe nëse nuk mund t'i përfundojmë nën kontroll, do të kemi telashe. Kjo është një skuadër e re dhe po rritet, por ne nuk mund të rrezohemi nga binarët. Në 30 minutat e fundit skuadra ishte e panjohur", ka shtuar Gattuso. Ndeshja e ardhshme e Milani është kundër Empolit.

Pogba sulmon Mou: Nuk luhet kështu

Fitoret e arritura kundër Watford në Premier League dhe kundër Young Boys në Champions League kanë qenë vetëm iluzione. Manchester United është akoma "i sëmurë" dhe shërimi duket shumë larg, po aq larg sa kryesuesit e kampionatit, Liverpool, që ka një avantazh prej tetë pikësh ndaj "Djajve të Kuq". Si të mos mjaftonte kjo, barazimi kundër Wolves ka rindezur polemikat mes Paul Pogba dhe Jose Mourinho. Në fakt, goli i barazimit të Wolves ka ardhur pas një topi të humbur nga francezi, i cili nuk i ka kursyer kritikën ndaj

stilit të lojës që bën portugezi. "Ishim në shtëpi dhe duhej të luanim me mirë, veçanërisht duhej të luanim në sulm", ka thënë Pogba. Kjo është e vetmja gjë që duhet të bëjmë kur luajmë në Old Trafford, të sulmojmë vazhdimisht. Në këtë mënyrë do të bënim më të lumtur tifozët dhe do të kishim më shumë mundësi për të fituar, siç kemi bërë vitin e kaluar kundër Tottenham, Arsenal, Chelsea e Liverpool". I pyetur nga gazetarët për arsyen pse skuadra nuk ka luajtur në këtë mënyrë, Pogba ka thënë: "Nuk mund të flas për këtë, nuk jam traj-



neri, por duhet të kemi më shumë alternativa. Tani duhet të ndërrojmë marsh, në shtëpi marrim

shumë pak pikë dhe vendet e para janë shumë larg", ka deklaruar Pogba.

Simeone mbron VAR-in: Me të, futboli është shumë më i drejtë



Diego Pablo Simeone mbrojti në një konferencë për shtyp përdorimin e VAR-it, pas polemikave që u ngritën mbi të në ndeshjen Barcelona-Girona. Trajneri i Atlético Madrid njehe se ka aspekte për ta përmirësuar "video-arbitrazhin", por në përgjithësi kjo teknologji e bën futbollin shumë më të drejtë: "Në Itali, VAR-i u prezantua vitin e kaluar dhe ka pasur edhe polemika. Në Kupën e Botës së Rusisë ishte mjaft mirë. Si çdo gjë

tjetër, edhe VAR-i mund të jetë i diskutueshëm, por unë mendoj se me të futboli është më i drejtë. Është e qartë se çdo gjest, ose situatë kontakti në lojë, kalon nëpër një filtër filmik, ndaj lojtarët ndihen në rrezik për t'u dëbuar me kartonë të kuq. Natyrisht, ata do të duhet të jetë më vigjilentë. VAR-i do të përmirësohet më tej dhe mendoj se shkon përtej drejtësisë njerzore të arbitrave", ka deklaruar Simeone.

FONDE EVROPIANE PËR MAQEDONINË EVROPIANE



www.izleziza.mk

- Ndhimja totale vjetore e BE-së për Maqedoninë është 90 milion euro, respektivisht 260.000 euro në ditë.
- Hyjmë në Union prej 500 milion konsumatorëve ose treg 250 herë më të madh se tregu vendor.
- 15.5 milion euro vjetore për Maqedoninë nëpërmjet Programës së BE-së për transport (fonde me të cilat ndërtohen rrugë, ura, hekurudha, tunele dhe infrastrukturë tjetër).
- 8.5 milion euro mjete evropiane për mbrojtjen e kufijve të Maqedonisë për vitin 2018.
- 15 milion euro mjete evropiane për bujqit në Maqedoni për vitin 2019.
- 18 milion euro në vitin 2020 për reformat në gjyqësor dhe policinë e Maqedonisë.

www.izleziza.mk

DASHI 21. mars - 20. prill
Këtë të hënë duhet ta merreni seriozisht me veten. Këshillohet që të lindurit e kësaj shenje, mbi të gjitha të kontrollojnë emocionet në të kundërt do të gjendeni mes telashesh. Instikti juaj ju bën të papërbajtshëm në ambjenti në punës ku ndoshta do keni konfrontime. Financat duken të stabilizuara.

DEMI 21. prill - 21. maj
Gjatë kësaj dite për të lindurit e kësaj shenje priten disa gjëra të paparashikuara ndaj duhet të jeni shumë i kujdesshëm. Qëndrojeni pranë njerëzve të afërt pasi ata mund të preken. Duhet të jeni energjikë dhe të gatshëm për të dhënë mbështetjen tuaj. Kujdes me shpenzimet.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Mos i harxhoni energjitë në aktivitete dhe gjëra pak të rëndësishme. Nuk është çështje pune apo parash, por çështje urtësie dhe mirëkuptimi. Nëse do t'i përqendroni të gjitha energjitë tuaja për qëllime fisnike do të shpërbleheni mirë. Financat janë nën kontroll.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Një ditë e mirë kjo e sotmja për juve. Do të përfshihen nga një shpirt iniciative për diçka krejtësisht të re që po vjen. Edhe në dashuri diçka do të ndezë më shumë lidhjen tuaj, në sajë të besimit tek vetvetja. Kujdes, edhe pse stresi duket se mund të fitojë, mos i jepni rëndësi dhe thjesht relaksohuni. Kujdes me financat.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Duhet të kujdeseni më shumë për veten tuaj. Ndjeni se keni më pak fuqi se sa mendoni se kishit, ndoshta për shkak të një kompleksi inferioriteti në raport me partnerin/en. Kjo ndoshta ndikohet edhe nga fakti se mund të ketë një punë më të mirë a më të mirëpërguar. Do të ripërtëriheni dhe do t'ia dilni të jeni më mire.

VIJGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Një ditë e mirë dhe vendimtare por me të dhëna pozitive për të lindurit nën shenjën e Virgjërshës. Sepse këtë ditë ju rikthehet stabiliteti si në lidhje nëse keni edhe në punë. Ndaj sot, ju këshillojmë veç relaks. Edhe financat duken në ditë të mirë.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Një ditë relativisht e mirë. Gjatë mbrëmjes, ju këshillohet të lexoni një libër jo i lodhshëm. Yjet këshillojnë që të kujdeseni më shumë për financat tuaja. Disa shpenzime që nuk i prisnit, ju kanë shkaktuar vrimë në kursimet tuaja dhe në paratë që shtyni muajin, ndaj rifilloni të jeni më të kujdesshëm në këtë pikë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Intuita që ju keni, rrallëherë gabon. Yjet ju dhurojnë një kurajë të madhe dhe besim në vetvete, ndaj dhe fati do t'ju shoqërojë gjatë gjithë kësaj të hëne. Në dashuri, mbështetja që do të gjeni nga partneri/ja, do t'ju bëjë që gjithçka t'ju duket edhe më magjike. Edhe financat në ditë të mirë.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Largoni pasiguritë dhe demonstroi kurajë për të bërë gjëra dhe do të shpërbleheni këndshëm. Sot mundet më në fund që t'i lejoni vetes, që si në punë dhe në dashuri, të jeni thjesht vetvetja. Partneri/ja do të mrekullohet nga veprimet tuaja, ashtu si dikur, në kohët e para të njohjes suaj. Kujdes me shpenzimet.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Një ditë jo fort e mirë në të cilën do të goditeni nga një gjendje e lartë stresi. Duhet të përballeni me disa diskutime dhe debate si në dashuri ashtu dhe në ambientin familjar. Bëni kujdes që të kontrolloni zemërimin dhe peshoni mirë tonet e fjalëve që do të nxirni, pasi mund të pendoheni. Disa probleme edhe me financat.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Keni nevojë për pak pushim. Shijoni pak kohë të lirë këtë ditë dhe merreni lehtë. Përpuni të hiqni qafe ndjenjën tuaj të detyrës dhe relaksohuni si duhet. Nëse ndonjë propozim mund t'ju vijë për të kaluar kohën, mos vendosni të pranoni po ju duket më tërësisht. Financat po stabilizohen.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Një ditë e mirë për të lindurit e kësaj shenje që ndihen aktivë dhe optimistë. Disa shanse të mria në horizont që nuk do t'i lini t'ju ikin nga duart. këtë ditë ju duhet të bëni diçka ndryshe, pse jo një festë. Nëse nuk i keni mudnësitë atëherë organzoheni për një ditë tjetër. Financat duken në ditë të mirë.

shumë i lehtë

7	2	9		5	4	1	
		9		4	2		
5						3	
3			4			8	
	1				3		
8				7		9	
4						7	
		7		5	9		
6	9		3		2	5	4


ACIDI I QUMESHTIT	NË FUSHË E DREJTËSISË	AKTORJA BRITANIKE NË FOTO	FILM ME AKTOREN NË FOTO	E PANJOHURA E PARË	LINDER E VOGEL (SH.)
L					
MJET LINDRIM, BARKA					
KALUMI					
P					
SHKRONË ARABE				KALUMI	DËSHMI
DITA PARA RAMAZANIT					
MORALI (SH.)					
E					
PJESËTAR I NJËTIVE (POPULL INDIJEN NË ALASKË)					FALAS
ABOULLAH ZENELI			TURGAU		
			FSHAT I NJËHUR NË QARAJIN E GJIRKASTRËS		
Mensur Mamuti	EDONA LLALLOSHI			RUMANIA	
	LUMI MË I MADH NË BOTË			FLET BOSH	
KLUB ITALIAN I BERGAMOS					
KARBURANTI, BENZINA					KËNGË SOLEMNE
					NËNAT
NJERI (PAPERVOUE (SH.)					ADEM DEMAÇI
					ZANORË TË NËJTA
FILM ME AKTOREN NË FOTO "MASKA E..."					GJYSMERRËSIRA E MBREMËS OSE E AGIMIT
					PJË ALKOOLIKE
AUTORI TURK KUTLAR					ISH FUTBOLLISTI SPANJOLL GONZALES (SHQ.)
QENDËR PËR KËRKIM E STUDIME SHKENCORE				TETOVA	
I					PARAFJALË GJERMANE
					AMPERI
IMPULSI		POASHTU (LAT)			KAMPIONI

KALUAN 6 MUAJ NGA HUMBIA E MË TË DASHURËS SONË



FLORIE SELA KASTRATI
06.08.1961-24.03.2018

Kaluan 6 muaj që kur nuk je në mesin tonë. Muajt e kaluar janë plot dhimbje shpirtërore, mall dhe mungesë, ditët kalojnë por nuk arrijnë dot ta shuajnë mallin dhe dhimbjen ndaj teje. I përjetshëm goftë kujtimi për ty, profesoreshë e dashur që me dhjetëra dhe qindra studentë me padurim të pritshin t'u ligjërosh lëndën përkatëse. E përkujtojmë me mallëngjim prindërit Idrizi dhe Tonka Sela, vajza Kreshnike Elmazi nga Kalishta me familjen, djali Kreshniku, vëllai Ili me familjen, motrat Kujtime Ahmeti dhe Bukurie Hoxha me familjet e tyre.



NË KËTË DATË

25 SHTATOR 1959

ZGJIDHJET: LAKTIK, VARKA, POTASI, KEF, K, ARIFE, ETIKAT, INUK, AZ, TG, ELL, R, ATALLANTA, B, MAZOTI, ODE, AXHAMITË, AD, ZOROS, MUGU, ONAT, RAULLI, INSTITUT, AN, I, ITEM, ASI.

ZBULIMI BEFASUES:

Njerëzit me kolesterol të lartë jetojnë më gjatë!

Shtatëmbëdhjetë kardiologë kryesorë të botës pohojnë se nivelet e larta të kolesterolit nuk shkaktojnë sëmundje të zemrës. Ata paralajmërojnë se statinat, ilaçet që ulin kolesterolin, nuk ofrojnë asnjë mbrojtje. Studimi i ri shtoi edhe diskutime rreth statineve dhe kardiologët nuk pajtohen në asnjë mënyrë nëse ka përfitime prej tyre. Ky studim i ri, bazuar në analizën e të dhënave prej 1.3 milion pacientëve, sugjeron që mbidozimi i statinës si forma kryesore e trajtimit të sëmundjeve të zemrës ka një efekt të



dyfishtë. Ekipi i këtyre mjekëve ka gjetur se nivelet e kolesterolit të keq LDL-C nuk janë të lidhur me sëmundjet e zemrës. Studimi nuk gjeti lidhje midis ateriosklerozës dhe niveleve të larta të kolesterolit të keq, pavarësisht nga literatura të shumta mjekësore që pretendojnë se depozitat e yndyrës në muret qelizore të

venave që bllokojnë arteriet janë për shkak të kolesterolit. Është e habitshme dhe doli se pacientët me sulme në zemër kanë kolesterol "të keq" më të ulët se normale. Profesori Sherif Sultan, një nga autorët, tha se zbulimi më i rëndësishëm është se njerëzit me kolesterol të lartë "të keq" jetojnë më gjatë.

Gjobë deri 500 euro nëse shtrihesh në tokë!

Venecia mund të gjobisë me 50 deri në 500 euro turistët e pasjellshëm. Autoritetet lokale kanë propozuar ndalimin e personave që ulen apo shtrihen në tokë. Rregulli është propozuar nga kryebashkiaku Luigi Brugnaro. Të ulesh në shkallët e monumenteve apo në ato të portikut që rrethon sheshin e Shën Markut, është aktualisht e ndaluar. Propozimi do të hidhet në votim në këshillin e qytetit në muajin tetor. Megjithatë, pritet të kundërshtohet nga këshilltarët e lëvizjes pesë yjet apo të gru-

peve të aktivistëve. "Ka një listë shumë të gjatë të gjërave që janë të ndaluara në Venecia sa që nuk ka mbetur më asgjë për të bërë", thotë një aktivist - do të duheshin madje 5 mijë oficerë policie shtesë që të garantohet respektimi i tyre. Autoritetet po shqyrtojnë edhe mundësinë e ndalimit të muzikës në barka. Që është mënyra kryesore e transportit për banorët. Prej kohësh Venecia stërmundohet të menaxhojë një industri turizmi që i sjell asaj rreth 60 mijë vizitorë në ditë.



KARIKIMI NATËN: Po i shkatërrojmë pa kuptuar

Studimet e fundit kanë treguar se gjatë gjithë kësaj kohe, kemi qenë duke e karikuar gabim aparatit celular. Ideja e të bërit këtë proces përgjatë gjithë natës, në fakt është tejet e dëmshme për telefonin. Kjo sepse në këtë mënyrë, celulari karikohet edhe kur bateria ka arritur 100% të mbushjes, e sipas specialistëve, kjo sjell vetëm tension ekstra për aparatit, çka do të thotë dëmtimin e baterisë, deri në skadimin përfundimtar të saj. Shpjegimi më konkret lidhet me faktin se bateria ka një përmbajtje acide, e cila nuk kërkon karikimin e plotë. Kuptohet, të gjithë dëshirojmë një celular të karikuar në maksimum për të nesërmen, por ka disa mënyra të tjera për ta arritur këtë, si psh: eliminimi i programeve që nuk i përdorim, përzgjedhja e zonave të mira me sinjal etj. Në fakt, mjafton vetëm një orë për të patur një bateri të qëndrueshme, kështu që rrjedhimisht do të na duhet të zbatojmë atë çfarë kanë rekomanduar specialistët.

BMW tërheq nga tregu kinez mbi 139 mijë vetura

BMW ka tërhequr nga tregu kinez 139 mijë e 452 vetura të saj për shkak të një defekti në një pjesë të klimës. Në një deklaratë nga Institucioni Shtetëror i Kontrollit dhe Rregullator i Tregut të Kinës, thuhet se tërheqja është kryer për shkak të një defekti në një pjesë të klimës që fryn erën. Në deklaratë vihet në dukje se procesi i tërheqjes përfshin 89.309 automjete të prodhuara gjatë periudhës maj 2005-korrik 2011 në Kinë, dhe 50.143 automjete të importuara gjatë periudhës janar 2005 dhe korrik 2011. Gjithashtu theksohet se BMW China Automotive Trading Ltd e cila është partneri kinez i BMW-së, do të kryejë pa pagesë kontrollet dhe ndërrimet e pjesëve me problem.



1066 - Bëhet Beteja e Stamfordit e cila shënon fundin e Epokës Anglo-saksone.

1340 - Anglia dhe Franca nënshkruajnë Traktat të çarmatimit.

1396 - Beteja e Nikopolisit: Sulltan Bejaziti I mund ushtarët e kryqëzatorëve.

1654 - Anglia dhe Danimarka nënshkruajnë Traktat të tregtisë.

1911 - Ania luftarake franceze Liberte eksplodon në limanin Toulon ku vdesin 285 persona.

1919 - Kryetari Woodrow Wilson paralizohet.

1972 - Norvegjia voton për t'iu bashkuar tregut të përbashkët.

1984 - Egjipti dhe Jordani i përmirësojnë marrëdhëniet diplomatike.

1990 - Saddam Husein paralajmëron se SHBA do të përsërisë përvojën e Vietnamit.



Sipas NHS, më shumë se një e katërta e të rriturve në Britani të Madhe kanë presion të lartë të gjakut, shumë prej të cilëve as nuk e dinë se vuajnë nga kjo gjendje. Për shkak të kësaj, presioni i lartë i gjakut njihet si "vrasësi i heshtur". Megjithatë, në disa raste, presioni i lartë i gjakut mund të zbulohet nëse përjetoni simptoma të caktuara në shikim. Sipas Superdrug Online Doctor, nëse keni probleme me shikimin tuaj, kjo mund të jetë një shenjë e presionit të lartë të gjakut. Simptoma tjera të tensionit të lartë përfshijnë edhe dhimbje koke, nauzea, shtrëngim në fytyrë, ushtimë në vesh dhe dridhje trupi.

ANKETA PËR USHQIMIN

Në mbarë botën u zhvillua një anketë me të njëjtën pyetje: "Cili është mendimi juaj për mungesën e ushqimit në pjesët tjera të botës?" Anketat përfundoi me rezultate katastrofë:

- Në Afrikë nuk e dinin se çka është ushqimi!
- Në Evropën Perëndimore nuk e dinin çka është mungesa!
- Në Evropën Lindore nuk e dinin çka është mendimi personal!
- Në Amerikë nuk e dinin çka është pjesa tjetër e botës!



Nëse shoh buzëqeshje në fytyrën e nënës time, atëherë gjithçka është në rregull...!

(Mark Twain)